



FLET PËR "EPOKËN E RE" FLORETË ZEJNULLAHU | FAQE 4-5

# PODUJEVA DO TA KETË NJË GRUA KRYETARE, 50 PËR QIND E EKIPIT TIM DO TË JENË GRA

Kandidatja e PDK-së për kryetare të komunës së Podujevës, Floretë Zejnullahu, ka shprehur bindjen se më 17 tetor llapjanët do ta votojnë atë për kryetare të kësaj komune. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se me qeverisjen e saj do t'ua kthejë dinjitetin qytetarëve të kësaj komune. Sipas saj, ndryshimi në këtë komunë vjen vetëm me qeverisjen e PDK-së. Zejnullahu është zotuar se ndryshimin do ta nisë nga zyra e saj. Ajo ka bërë me dije se ekipi i saj do të përbëhet 50 për qind nga gratë



## SHBA-ja IA DHURON FSK-së 55 AUTOMJETE USHTARAKE

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ia kanë dhuruar 55 automjete ushtarake Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Me këtë rast, presidentja Vjosa Osmani ka thënë se këto automjete ushtarake do t'i ndihmojnë FSK-së t'i ngrehë kapacitetet

e saj për ruajtjen dhe garantimin e paqes. Edhe kryeministri Albin Kurti ka thënë se donacioni amerikan prej 55 automjetesh do t'i shërbejë FSK-së që të jetë garantuese e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë



### OPINION

22 "MEGA-SHKATËRRIMET"  
22-VJEÇARE QË  
PËRFUNDIMISHT  
"FUNDOSËN" KOSOVËN F. 8

Shkruan:  
Agron HOTI



### AKTUALE



HAJDIN ABAZI DORËZON  
DETYRËN E AMBASADORIT  
PA LËNË PASARDHËS F. 4-5

KURTI: BE-ja TA BËJË  
ZGJERIMIN MË TË DREJTË  
DHE MË TË NDERSHËM F. 6

VLORA ÇITAKU: QEVERIA E  
SUSPENDON POLITIKËN E JASHTME F. 7

20 TË VDEKUR DHE 932 RASTE TË  
REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

### EKONOMI

MINISTRIA E INDUSTRIË,  
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË  
NDAN 3.65 MILIONË EURO  
GRANTE F. 8

REFUZIMI I TREGUT ME MILIONA  
KONSUMATORË F. 8



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Vlora Çitaku: Qeveria e suspendon politikën e jashtme

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se qeveria aktuale e ka suspenduar politikën e jashtme. Ish-ambasadorja e Kosovës në ShBA ka shkruar në faqen e vet në "Facebook" se nga hëna shumica e ambasadave të Republikës së Kosovës janë pa titullar, pa shef misioni dhe pa të ngarkuar me punë. Ajo e ka

quajtur këtë suspendim të politikës së jashtme papërgjegjësi të presidentes e të kryeministrit ndaj shtetit dhe mungesë konsiderate për shtetin nikoqir. "Nga sot shumica e ambasadave të Republikës së Kosovës janë pa titullar, pa shef misioni dhe pa të ngarkuar me punë. Ka edhe ambasada të cilave u është vënë dryni. Kjo është papërgjegjësi totale ndaj shtetit. Ky është

suspendim i politikës së jashtme. Qeveria dhe Presidenca kanë pasur mjaftueshëm kohë që t'i përzgjedhin ambasadorët. Nuk ka asnjë arsytim. Papërgjegjësi ndaj shtetit dhe mungesë konsiderate për shtetin nikoqir. Në diplomaci, nëse e tërheq shefin e misionit, pa dërguar emrin e pasuesit, një shtet dërgon mesazh", ka shkruar Çitaku.



## Vaksinimi në Shqipëri kërkohet të jetë i detyrueshëm për disa kategori

TIRANË, 30 GUSHT - Shqipëria, nga 1 shtatori, do t'i shtrëngojë masat kundër përhapjes së koronavirusit, në përpjekje për ta ulur numrin e të infektuarve.

Në mbledhjen e Komitetit Teknik të Ekspertëve është propozuar që orari i lëvizjes së qytetarëve të ndryshojë nga 24:00 - 06:00 në 23:00 - 06:00, pasi ditët e fundit është rritur numri i personave të infektuar me koronavirus.

Vaksinimi kërkohet të jetë i detyrueshëm për stafin mjekësor, pedagogët dhe studentët, duke filluar nga fillimi i muajit tetor.

Kryetarja e Komitetit Teknik të Ekspertëve, Mira Rakacolli, ka thënë se komiteti ka rekomanduar që të gjithë personave të këtyre kategorive t'u kërkohet paraqitja periodike e testit PCR, për të



vërtetuar gjendjen e tyre shëndetësore.

Ndërsa ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, ka thënë se duke filluar nga shtatori, do të ndryshojë plani i vaksinimit për disa kategori, me qëllim për të

shpëtuar jetë.

"Shtatori do të jetë muaji i dytë i hapur për vaksinimin. Do të nisim shumë shpejt zbatimin e planit për kalimin në një tjetër fazë të fushatës së vaksinimit, ku detyrimi i disa kategorive për t'u vaksinuar do të

bëhet në emër të së drejtës së të tjerëve për të mos u infektuar. Të gjitha vendet po lëvizin në këtë drejtim dhe ne do ta bëjmë pa humbur kohë në ditët në vijim", ka thënë Manastirliu.

Në konferencën për media, Manastirliu ka thënë se varianti "Delta" i koronavirusit "po përhapet me shpejtësi të frikshme" dhe se po infektion njerëz që janë të pavaksinuar.

"Delta" po përhapet me shpejtësi të frikshme, po infektion njerëz që nuk e kanë bërë vaksinën, ndaj pandemia e koronavirusit ia kalon vendin pandemisë së të pavaksinuarve", ka thënë ajo.

Me masat e reja, nga 6 shtatori, qytetarët që hyjnë në Shqipëri duhet të kenë pasaportë vaksinimi, test PCR negativ jo më të vjetër se 72

orë, ose vërtetim të shërimit nga koronavirusi jo më të vjetër se gjashtë muaj.

Këto rregulla do të vlejné edhe për personat që kalojnë tranzit nëpër Shqipëri. Po ashtu, nga data 1 shtator do të ndalohet hyrja e personave të tjerë në aeroporte veç pasagjerëve; në ambientet e mbyllura, maska do të jetë e detyrueshme, ndërsa qytetarët që kthehen në Shqipëri duhet të izoloohen për 10 ditë dhe të njoftojnë autoritetet për kryerjen e testit për koronavirus, pas përfundimit të izolimit.

Në Shqipëri janë rreth 9 230 raste aktive me koronavirus. Prej paraqitjes së rastit të parë në muajin mars të vitit 2020, në Shqipëri janë infektuar rreth 150 mijë persona, prej këtyre 2 492 kanë vdekur.

## Gabriel Escobar pritet të zëvendësojë Matthew Palmerin

WASHINGTON, 30 GUSHT - Zëvendësambasadori i Shteteve të Bashkuara në Serbi, Gabriel Escobar, javën e ardhshme pritet ta marrë detyrën e zëvendësndihmëssekretarit për Çështje të Evropës dhe Euroazisë në Departamentin Amerikan të Shtetit (DASH). Ky lajm është konfirmuar për agjencinë e lajmeve serbe "Beta" nga Ambasada Amerikane në Beograd.

Deri më tani këtë post e ka mbajtur Matthew Palmer, i cili ka qenë edhe përfaqësues i

posaçëm i DASH-it për Ballkanin Perëndimor.

Kush është Gabriel Escobar?

Gabriel Escobar në gusht të vitit 2019 është emëruar në postin e zëvendëshefit të misionit në Ambasadën Amerikane në Beograd. Më herët ai kishte shërbyer si i ngarkuar me punë në këtë ambasadë.

Nga viti 1998 deri më 2001 Gabriel ka përfunduar katër turne radhazi në ish-Jugosllavi, ku ka shërbyer edhe si shef i stafit në Zyrën e përfaqësuesit të lartë në Banja Llukë të Bosnje e

Hercegovinës, shef i Degës së Ambasadës në Banja Llukë, zëvendësndrejtor i ekipit të Zyrës Ndërlidhëse Diplomate të ShBA-së në Podgoricë dhe më 2001, pak pasi u rihap Ambasada në Beograd, ka shërbyer si shef i njësisë politike në Ambasadën Amerikane.

Ndërsa në Byronë për Çështje Evropiane, Gabrieli ka shërbyer si këshilltar për çështje politike dhe ekonomike në ambasadën në Lisbonë, zëvendëskëshilltar politik në Romë dhe zyrtar ushtarak politik në Pragë si dhe



zëvendëskonsull në Moskë.

Gabrieli, një diplomat karriere, është nderuar gjashtë herë nga Departamenti Amerikan i Shtetit me Çmimin e Lartë të Nderit dhe

një herë me Çmimin për Merita të Larta. Ai, po ashtu, është nderuar nga DASH-i për Çmimin për Shërbimin Civil si dhe ka marrë Çmimin për Shërbim Ushtarak. Po ashtu, ai ka mbajtur pozita të larta në Ambasadën Amerikane në Bagdad, në La Paz, Peshavar si dhe ka qenë udhëheqës i ekipit amerikan për rindërtim në Kirkuk të Irakut.

Gabrieli ka diplomuar në Universitetin Colombia në Nju-Jork dhe flet gjuhën spanjolle, ruse, italiane, serbe, çeke dhe portugeze.

## Ngjarjet në Afganistan, Borrelli përmend nevojën për një plan reagimi që diskutohej gjatë luftës në Kosovë

BRUKSEL, 30 GUSHT - Qeveritë e vendeve të Bashkimit Evropian (BE) duhet të ecin përpara me një forcë evropiane të reagimit të shpejtë për t'u përgatitur më mirë për krizat e ardhshme sikur ajo në Afganistan, ka thënë shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell.

Në një intervistë të botuar të

hënën, Borrelli i ka thënë gazetës italiane "Il Corriere della Sera", se dislokimi i trupave amerikane në Afganistan me përkeqësim të sigurisë tregoi se BE-ja kishte nevojë t'i përshejtohte përpjekjet për ta ndërtuar një politikë të përbashkët mbrojtëse.

"Ne duhet të nxjerrim mësim

nga kjo përvojë... si evropianë ne nuk kemi qenë në gjendje t'i dërgojmë 6 000 ushtarë rreth aeroportit të Kabulit për ta siguruar zonën. ShBA-ja ka qenë, ne nuk e kemi bërë", ka thënë ai.

Borrelli ka thënë se 27 anëtarët e BE-së duhet të kenë një "forcë fillestare hyrëse" prej 5 000

ushtarësh. "Ne duhet të jemi në gjendje të veprojmë shpejt".

Në maj, 14 vende të BE-së përfshirë Gjermaninë dhe Francën, kanë propozuar një forcë të tillë, ndoshta me anije dhe avionë, për t'i ndihmuar qeveritë e huaja demokratike që kanë nevojë për ndihmë urgjente.





# ShBA-ja ia dhuron FSK-së 55 automjete ushtarake

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ia kanë dhuruar 55 automjete ushtarake Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Me këtë rast, presidentja Vjosa Osmani ka thënë se këto automjete ushtarake do t'i ndihmojnë FSK-së që t'i ngrehë kapacitetet e saj për ruajtjen dhe garantimin e paqes. Edhe kryeministri Albin Kurti ka thënë se donacioni amerikan prej 55 automjetesh do t'i shërbejë FSK-së që të jetë garantuese e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka pranuar 55 automjete ushtarake të dhuruara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Këto pajisje ushtarake, sipas presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, do ta ndihmojnë FSK-në që t'i ngrehë kapacitetet për ruajtjen dhe garantimin e paqes. Osmani ka thënë se ndihma e ShBA-së në transformimin e FSK-së është e një rëndësie të veçantë. "Këto pajisje do t'u ndihmojnë ju edhe më tej që t'i zhvillonin kapacitetet tuaja, të parapara në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, mbështetur në misionin dhe mandatin tuaj të ri. Këto do të ndikojnë që aftësitë operationale të FSK-së të rriten dukshëm si dhe që ushtria jonë të jetë plotësisht ndërvepruese me partnerët tanë, sidomos me

ShBA-në, duke ndikuar që së bashku me ta të jetë garantuese e paqes dhe stabilitetit jo vetëm në rajon, por në gjithë botën", ka thënë Osmani gjatë ceremonisë së pranimi të këtyre automjeteve. Osmani ka thënë se shpreson se faza tjetër e tranzicionit të FSK-së të përfshijë edhe pajisjen me helikopterë.

Më tutje, presidentja Osmani ka thënë se FSK-ja është e përkushtuar që të përfundojë sa më shpejt fazën e tranzicionit dhe se në këtë, sipas saj, kontribut të madh janë duke dhënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se donacioni amerikan prej 55 automjetesh do t'i shërbejë FSK-së që të jetë garantuese e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. "Në do të vazhdojmë të



zhvillojmë politikat e mbrojtjes, ta përditësojmë kornizën ligjore dhe të ndërtojmë kapacitete operationale të FSK-së në atë drejtim që të jenë të përputhshme dhe të ndërveprueshme me NATO-n dhe me qëllim përafrimin dhe anëtarësimin në këtë organizatë", ka thënë kryeministri Kurti.

Në anën tjetër, ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka falënderuar ShBA-në për këtë donacion. "Siguria mbi të gjitha! Faleminderit

Amerikë për sigurinë, faleminderit për ndihmën për ushtrinë e Kosovës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Automjetet që qeveria amerikane i ka dhuruar FSK-së janë të tipit "Armored Security Vehicle - ASV". Prodhimi i këtyre automjeteve ushtarake ka filluar në vitet '90 dhe ato përdoren gjerësisht në ushtrinë amerikane. Kohë më parë Kosova kishte blerë 51 automjete të tjera ushtarake nga ShBA-ja. Në vitin 2018 ishte

nënshkruar kontrata ndërmjet kompanisë amerikane "AM General" dhe Qeverisë së Kosovës për pajisjen e FSK-së me 51 automjete të tipit "Humvee". Së fundmi, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për blerjen e katër dronëve për nevoja të FSK-së në vlerë rreth 11 milionë euro. Automjete ushtarake, po ashtu, janë blerë nga Turqia. Javë më parë Kosova ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e 14 automjeteve ushtarake të blinduara nga shteti i Turqisë. Zyrtarët e Ministrisë së Mbrojtjes patën deklaruar se blerja e automjeteve ushtarake për Forcën e Sigurisë së Kosovës është pjesë e procesit të tranzicionit të kësaj force në ushtri të ardhshme të Kosovës.

Në dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës kishte ndryshuar mandatin e FSK-së dhe në bazë të ndryshimeve ligjore, parashihet që kjo forcë në një periudhë prej 10 vjetësh të ketë kapacitete të plota ushtarake. Përgjegjësitë e reja të FSK-së kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, qytetarëve, pronave dhe interesave të Republikës së Kosovës, si dhe mbështetje ushtarake për autoritetet civile dhe pjesëmarrjen në operationet ndërkombëtare.



## Në Kosovë arrin grupi i parë i afganëve

PRISHTINË, 30 GUSHT - Në Kosovë ka aritur grupi i parë i qytetarëve afganë, prej 111 personash, të cilët kanë ikur nga shteti i tyre, pasi talebanët morën kontrollin. Ata janë transportuar nga Gjermania me një avion të forcave ajrore amerikane, i cili ka aterruar në Kosovë pak pas orës 20:00 të datës 29 gusht. Autoritetet e Kosovës kanë njoftuar se edhe gjatë të hënës pritet të arrijë grupi tjetër i

afganëve.

Qytetarët afganë, që kanë punuar me NATO-n, së bashku me familjet e tyre do të qëndrojnë përkohësisht në Kosovë derisa t'u rregullohen dokumentacionet për qëndrim afatgjatë në Shtetet e Bashkuara. Në mesin e tyre ka gra dhe fëmijë.

Afganët që kanë arritur në Kosovë do të strehohen në ish-kampin e kompanisë "Bechtel -

Enka" që gjendet pranë bazës ushtarake amerikane "Bondsteel" në Ferizaj. Për t'i pritur qytetarët afganë, në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" dolën presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Philip Kosnett. Kosova pritet t'i pranojë 2 000 afganë.







FLET PËR "EPOKËN E RE", FLORETË ZEJNULLAHU

# Podujeva do ta ketë një grua kryetare, 50 për qind e ekipit tim do të jenë gra

Kandidatja e PDK-së për kryetare të komunës së Podujevës, Floretë Zejnullahu, ka shprehur bindjen se më 17 tetor llapjanët do ta votojnë atë për kryetare të kësaj komune. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se me qeverisjen e saj do t'ua kthejë dinjitetin qytetarëve të kësaj komune. Sipas saj, ndryshimi në këtë komunë vjen vetëm me qeverisjen e PDK-së. Zejnullahu është zotuar se ndryshimin do ta nisë nga zyra e saj. Ajo ka bërë me dije se ekipi i saj do të përbëhet 50 për qind nga gratë

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 30 GUSHT** - Kandidatja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetare të komunës së Podujevës, Floretë Zejnullahu, ka shprehur bindjen për fitore më 17 tetor. Ajo ka treguar se bashkë me ekipin e saj janë duke e finalizuar një program shumë praktik dhe të realizueshëm për Podujevën.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Zejnullahu ka deklaruar se epiqendër e këtij programi do të jetë qytetari. "Unë jam e bindur se Podujeva do ta ketë një grua

kryetare. Mendoj se është koha dhe qytetarët do ta dëshmojnë këtë, jo për faktin se është në pyetje një grua, por çka kam dëshmuar gjatë tërë këtyre viteve me këmbëngulje, me punë dhe e palëkundur për të mirën e Podujevës", ka thënë ajo.

Zejnullahu ka vlerësuar se përparimi i kësaj komune vjen vetëm me qeverisjen e PDK-së. "Qytetarët e Podujevës e kanë jetuar qeverisjen e LDK-së dhe të LV-së, por asnjë përparim nuk ka ndodhur. Përparimi vjen vetëm përmes ndryshimit dhe jo ripërsëritjes së të njëjtave gabime. Podujeva ka humbur shumë nga këto gabime. Duhet

ndryshim. Llapi dhe Podujeva përparimin e kanë përjetuar vetëm nga qeverisja e PDK-së në nivel nacional, nga koha kur PDK-ja ka udhëhequr Qeverinë e Kosovës për Podujevën janë investuar mbi 62 milionë euro", ka deklaruar Zejnullahu.

Ajo është zotuar se me qeverisjen e saj në Podujevë do të sjellë projekte që do t'ua kthejnë dinjitetin llapjanëve. "Podujevën do ta bëjmë me Zonë Ekonomike, do të hapim mundësi që shumë biznese të hapen aty dhe të krijohen vende të reja të punës. Bizneset që janë larguar nga Podujeva do t'i kthejmë në qytetin tonë. Fokus do të kemi në investimet

në infrastrukturë, arsim dhe bujqësi", ka deklaruar ajo, duke i siguruar qytetarët e Podujevës se ndryshimi do të nisë nga zyra e saj. "Nuk do ta kenë një kryetare të komunës që shikon nga lart, por do të jem në shërbim të ofrimit të zgjedhjes së problemeve duke marrë shembujt më të mirë. Gratë do të kenë hapësirë në udhëheqjen e re në Podujevë. Ekipi im do të përbëhet nga 50 % gra. Ekip im dhe unë do të punojmë me transparencë që prej ditës së parë. Për këtë jam zotuar dhe qytetarët e dinë këtë", ka thënë ajo.

**"Epoka e re": Floretë Zejnullahu, a mund të na tregoni për lexuesit e gazetës "Epoka e re" se kush është Floretë Zejnullahu?**

**Zejnullahu:** Unë jam Floretë Zejnullahu, jetoj në fshatin Lladoc të Podujevës, kam përfunduar studimet master në

Fakultetin e Mjekësisë, drejtimi Farmaci. Angazhimi im politik ka filluar së pari si anëtare e Rinisë Demokratike të Kosovës, më pas kam qenë asambleiste në komunën e Podujevës. Falë besimit të qytetarëve për dy mandate kam arritur të zgjedhem deputete në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, për një mandat kam shërbyer dhe si anëtare e Kryesisë së PDK-së në nivel nacional.

**"Epoka e re": Pse vendosët të garoni për kryetare të komunës së Podujevës?**

**Zejnullahu:** Unë i kam hyrë garës sepse besoj se Podujeva ka nevojë për dikë që i njih problemet e Podujevës. Kandidatura ime shpreh vullnetin dhe dëshirën time dhe të PDK-së, që me përgatitjen time, dijen, përvojën dhe përkushtimin t'i shërbejë qytetin tim dhe qytetarëve. U



ndjeva e obliguar ndaj Podujevës sepse jam e sigurt se qyteti im ka nevojë që njerëzit e saj të veprojnë dhe punojnë për të mirën dhe zhvillimin e saj. U binda se Podujeva ka nevojë për një kryetare me një qasje bashkëpunuese, me një përvojë dhe me një njohje të mirë të problemeve të bashkëqytetarëve, pasi që në mënyrë të vazhdueshme i kam adresuar si asambliste në Kuvendin Komunal, por edhe si deputete në Kuvendin e Kosovës, pa marrë parasysh se kush ka qeverisë në Podujevë. Oferta dhe përkrahja e fuqishme nga Partia Demokratike e Kosovës më dha kurajë më të madhe që t'i hyj garës për kryetare të Podujevës, që të vazhdoj të punoj dhe ndihmoj qytetin tim dhe qytetarët e tij. Vendimi nuk ka qenë edhe aq i lehtë, por e kam vlerësuar si domosdoshmëri që përvojën time ta vë në shërbim të qytetit tim. Podujeva e meriton një qeverisje shumë më të mirë sesa që e kemi përjetuar deri më tani.

**“Epoka e re”:** Ju jeni mbesa e heroit Hakif Zejnullahu. Sa do t'ju ndihmojë kjo në këtë garë?  
**Zejnullahu:** Jam e bindur që të ardhmen do të mund ta ndërtoj duke nderuar dhe respektuar të kaluarën. Kjo rrugë është sfidë e madhe, por jam e bindur që familja ime, të gjithë qytetarët dhe unë do të dalim faqebardhë. Ideali i familjes sonë, i personifikuar me patriotizëm dhe luftë për lirinë dhe shtetin e Kosovës, është krenari dhe nder, por këtë ideal nuk do ta përdor në asnjë

moment për përfitime politike. Xhaxhi im, shokët e tij dhe secili luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë bërë luftë të shenjtë dhe unë gjithmonë do të përkulem me nder e respekt para veprës së tyre. Ata u ngritën në këmbë për të gjithë ne. Falë tyre në sot jetojmë të lirë, jetojmë në shtetin e Kosovës dhe e kemi amanet ta ruajmë, ndërtojmë e zhvillojmë atë.

**“Epoka e re”:** Pse lllapjanët duhet t'ju votojnë ju dhe PDK-në ditën e zgjedhjeve?  
**Zejnullahu:** Podujeva duhet të përjetojë ndryshimin e madh, këtë ndryshim e kërkojnë lllapjanët. Në Podujevë na duhet vizion i ri, drejtimi i ri, energji të reja. Me punë, plan konkret dhe transparencë e qeverisje me duar të pastra mbi të gjitha, Podujeva do të përjetojë ndryshime të mëdha. Unë do t'i sjell Podujevës projekte inovative të cilat do të garantojnë më shumë mundësi për të rinjtë, vende pune e hapje të bizneseve, investime në sport e kulturë, dhe do të garantoj më shumë barazi për qytetarët. Do të investojmë në bujqësi dhe në krijimin e Zonës Ekonomike për Llapin. Mendoj me një qasje çfarë kam unë, me një vizion të cilin e kam, shumë të qartë, se si duhet të jetë dhe të funksionoj qeverisja e ardhshme e Podujevës, që në epiqendër ka qytetarin, do ta bëjmë ndryshimin e merituar.

**“Epoka e re”:** Kjo komunë tradicionalisht ka qenë bastion i LDK-së, ndërsa tani qeveriset nga LV-ja. Si është qeverisur kjo



komunë nga këto dy parti?

**Zejnullahu:** Kandidatët i respektoj të gjithë, do të jetë një garë interesante. Unë jam e bindur se Podujeva do ta ketë një grua kryetare. Mendoj se është koha dhe qytetarët do ta dëshmojnë këtë, jo për faktin se është një pyetje një grua, por çka kam dëshmuar gjatë tërë këtyre viteve me këmbëngulje, me punë dhe e palëkundur për të mirën e Podujevës. Qytetarët e Podujevës e kanë jetuar qeverisjen e LDK-së dhe LV-së, por asnjë përparim nuk ka ndodhur. Përparimi vjen vetëm

përmes ndryshimit dhe jo ripërsëritjes të të njëjtave gabime. Podujeva ka humbur shumë nga këto gabime. Duhet ndryshim. Llapi dhe Podujeva përparim e ka përjetuar vetëm nga qeverisja e PDK-së në nivel nacional. Nga koha kur PDK-ja ka udhëhequr Qeverinë e Kosovës për Podujevën janë investuar mbi 62 milionë euro. Është koha që Podujeva të qeveriset nga ne edhe në nivelin lokal. Unë këtë garë e shoh edhe si një përpjekje të përbashkët me të gjithë qytetarët që dëshirojnë që

Podujeva jonë të jetë qytet i të gjithëve. Kjo nuk është garë për një post. Është garë e qytetarëve për qytetin.

**“Epoka e re”:** Cila është oferta juaj për Podujevën dhe çfarë pritje keni për 17 tetorin?  
**Zejnullahu:** Ne po finalizojmë një program shumë praktik, shumë real, i kapshëm dhe i realizueshëm ku, përveç të tjerash, do të ketë në epiqendër qytetarin, me theks të veçantë të rinjtë. Të rinjtë janë e tashmja, nuk janë thjesht vetëm e ardhmja, tash duhet të investohet në ta, që ata të jenë liderë të së ardhmes. Garantoj se në Podujevë do të sjell disa projekte jashtëzakonisht të mira, që do të ndihmojnë këtë vend dhe t'u kthehet dinjiteti të gjithë lllapjanëve. Podujevën do ta bëjmë me Zonë Ekonomike. Do të hapim mundësi që shumë biznese të hapen aty dhe të krijohen vende të reja të punës. Bizneset që janë larguar nga Podujeva do t'i kthejmë në qytetin tonë. Fokus do të kemi investimet në infrastrukturë, arsim dhe bujqësi. Qytetarët e Podujevës i siguroj se ndryshimi i parë do të nisë nga zyra ime. Nuk do ta kenë një kryetare të komunës që shikon nga lart, por do të jem në shërbim të ofrimit të zgjedhjes së problemeve duke marrë shembujt më të mirë. Gratë do të kenë hapësirë në udhëheqjen e re në Podujevë. Ekipi im do të përbëhet nga 50 për qind gra. Ekipi im dhe unë do të punojmë me transparencë që prej ditës së parë. Për këtë jam zotuar dhe qytetarët e dinë këtë.

## Hajdin Abazi dorëzon detyrën e ambasadorit pa lënë pasardhës

**KANABERA, 30 GUSHT (ER)** - Hajdin Abazi ka njoftuar se ka përfunduar punën e ambasadorit të Republikës së Kosovës në Australi. Ai në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se askush nuk i ka shkruar për ta bërë pranim-dorëzimin e ambasadës. “Sot ishte dita e fundit e punës sime si ambasador. Prita deri në ora 17:00 minuta me kohën e Australisë, dhe me kohën e Kosovës ora është 09:00 minuta. Askush nuk erdhi për të bërë pranim-dorëzimin në Ambasadën e Republikës së Kosovës. Më erdhi ndërmend fakti se qysh në vitin 2000, për herë të parë pasluftës çlirimtare, kam bërë dorëzim-pranimin e pushtetit në Ferizaj – në mënyrë ceremoniale për të instaluar frymën e demokracisë dhe të tolerancës politike, kurse sot, e 21 vjet më pas, nuk u bë ky akt institucional, për shkak se

qeveria edhe pas tre muajve dështoi të sjellë një diplomat dhe aktualisht ambasada mbeti pas asnjë diplomat të vetëm. Ç’është e vërteta, kam kërkuar instruksione se si të veprojmë nga MPJD-ja, por askush, prej ministres, kabinetit të saj e deri te sekretarja, nuk më kanë kthyer as email”, ka shkruar Abazi. Më tutje, ai ka thënë se tani e tutje nuk ka asnjë përgjegjësi për Ambasadën e Kosovës në Australi. “Në punën time në Kanberë, shpesh kam menduar se raportimet financiare për çdo muaj dhe kontrolli nga ministria ishin të tepruara, por sot u binda se sa me vend është ky raportim, sidomos në raste të këtilla të mos bërjes së dorëzim-pranimit. Duke qenë se në Ambasadë ka materiale konfidenciale, vula, materiale konsullore, aparatura, vetura me targa diplomatike etj. etj., unë e kam bërë skenimin e gjendjes ashtu sikurse po e lë



Ambasadën që ta kem si dëshmi. Nga ky çast, unë nuk kam përgjegjësi për Ambasadën. E mbylla Ambasadën duke lënë gjithçka sikurse ishte, në mënyrë të rregullt, i lashë të gjithë çelësat brenda dhe më nuk kam asnjë qasje në të, dhe në ora 17:07 minuta dola nga Ambasada.

Qoftë edhe për ca javë, Ambasada de facto është e mbyllur, pasi që aty është vetëm stafi teknik dhe asnjë komunikim zyrtar në emër të ambasadës nuk mund të bëhet”, ka shkruar Abazi, i cili ka falënderuar bashkëshorten e tij dhe bashkëpunëtorët. “Për dy vite e

tre muaj sa isha ambasador, kam pasur shumë përkrahje dhe mbështetje në të gjitha aktivitetet që kam ndërmarrë, prandaj dua të falënderoj komunitetin shqiptar në Dandenong, në Adelaide, në Shepparton, në Sydney, në Perth, Kanberë dhe atë në Melbourne, Shoqatën e Gruas, klubet futbolistike shqiptare ‘Prishtina’ dhe ‘Shqiponja’. Dua të falënderoj edhe bashkëshorten time, Fitoren, e cila nuk iu nda sfidave me mua dhe e kisha inkurajues në gjithçka. Nga nesër, unë më nuk kam asnjë përgjegjësi institucionale, i kthehem profesionit tim shkencor. Nuk do të heshtë, sepse këtë nuk e kam bërë nga rinia e hershme edhe kur kishte çmim të shtrenjtë ngritja e zërit, por do të bëhem krah i atyre që angazhohen për mbrojtjen e lirisë dhe të demokracisë në Kosovë, vlera këto të cilat po manipulohen”, ka shkruar Abazi.



Kosova shënon Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur

# Osmani: Asnjë çështje nuk është më prioritare në procesin e dialogut me Serbinë sesa kthimi i më të dashurve tanë

Republika e Kosovës të hënën ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur. Me këtë rast, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se të zhdukurit do t'i mungojnë jo vetëm shpirtit të gjithsecilit prej nesh, por edhe shpirtit të një shteti dhe kombi të tërë. Ajo ka thënë se asnjë çështje nuk është më prioritare në procesin e dialogut me Serbinë sesa kthimi i më të dashurve tanë. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se në raportet me Serbinë çështja e të zhdukurve me dhunë është kryefjalë dhe "ne nuk mund të pretendojmë që të kemi as të ardhme të qëndrueshme e të sigurt nëse nuk adresojmë çështjet e së kaluarës, nëse nuk e trajtojmë dhe nuk e sqarojmë të kaluarën"



ku janë kryer krimet, si dhe ndihmon hetuesit t'i identifikojnë të dyshuarit dhe t'i lidhin ata me ngjarje të veçanta", ka thënë Roland Burgsteiner, analist i EULEX-it për krimet e luftës, i cili ka ndihmuar në zhvillimin e bazës së të dhënave. Burgsteiner ka theksuar se baza e të dhënave është në përdorim të plotë dhe tashmë përfshin rreth 400 raste të krimeve të luftës.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, më 1998/99, janë vrarë rreth 13 500 persona, shumica dërrmuese shqiptarë. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur. Javën e kaluar Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Kodin e Procedurës Penale, në bazë të të cilit do të rregullohet gjykimi në mungesë i të akuzuarve për krime lufte.

**Krasniqi: Institucionet duhet të angazhohen më shumë për fatin e të pagjeturve**

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që të angazhohen më shumë për fatin e personave të pagjetur. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se institucionet ndërkombëtare sa më shpejt duhet t'i vënë para drejtësisë kriminelët e luftës që kanë qenë përgjegjës për zhdukjen e këtyre personave. "Sot përkujtojmë personat e zhdukur në Ditën Ndërkombëtare të tyre. Kjo ditë duhet të ketë rol për të ngritur vetëdijen për fatin e të pagjeturve të Kosovës dhe gjendjen e rëndë të familjeve të tyre. Fatkeqësisht, kanë kaluar mbi dy dekada prej përfundimit të luftës së Kosovës dhe mijëra qytetarë presin gjithë dhimbje të mësojnë fatin e të afërmit të tyre. Institucionet e vendit duhet të angazhohen më shumë për zgjidhjen e fatit të të gjithë personave që janë të zhdukur, si dhe institucionet ndërkombëtare duhet sa më shpejt të vënë para drejtësisë kriminelët e luftës që kanë qenë përgjegjës për zhdukjen e tyre", ka shkruar Krasniqi.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 30 GUSHT** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, së bashku me kryeministrin Albin Kurti dhe me familjarët e personave të zhdukur me dhunë, në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur me dhunë kanë vendosur kurorë me lule pranë memorialit për personat e pagjetur. Me këtë rast, presidentja Osmani ka thënë se ata do t'i mungojnë jo vetëm shpirtit të gjithsecilit prej nesh, por shpirtit të një shteti të tërë, shpirtit të një kombi të tërë. "Fati i tyre bëhet edhe shumë më tragjik kur dihet që janë në duart e shtetit serb, një shteti që ka ushtruar gjenocid ndaj popullit të Kosovës e që, fatkeqësisht, ende nuk po distancohet nga kjo e kaluar e tmerrshme dhe nga krimet që ka kryer ndaj popullit tonë. Por, duke e ditur që të zhdukurit me dhunë janë plaga jonë më e thellë, janë ndër plagët më të mëdha të Kosovës së pasluftës, kjo i bën përpjekjet tona shumëfish më të mëdha për ta zbardhur fatin e tyre, për të kërkuar përgjegjësi nga Serbia dhe për t'u siguruar që asnjë çështje nuk është më prioritare në procesin e dialogut me Serbinë sesa kthimi i më të dashurve tanë", ka thënë presidentja Osmani. Më tutje, ajo ka theksuar se asnjë dhimbje nuk është më e madhe, rrjedhimisht asnjë çështje nuk mund të jetë asnjëherë prioritet më i madh. "Dhimbja nuk është vetëm e familjarëve. Ata, siç e kam thënë gjithmonë, janë edhe

familjarët tanë, janë njerëzit tanë, janë motrat e vëllezërit tona, janë bijtë e bijat tona. Prandaj, dhimbjen e kemi të përbashkët dhe vetëm bashkë mund ta përballojmë e vetëm bashkë mund të kërkojmë përgjegjësi nga shteti i cili i ka zhdukur ata me dhunë", ka theksuar Osmani. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se në raportet tona me Serbinë çështja e të zhdukurve me dhunë është kryefjalë dhe ne nuk mund të pretendojmë që të kemi as të ardhme të qëndrueshme e të sigurt, nëse nuk adresojmë çështjet e së kaluarës, nëse nuk e trajtojmë dhe nuk e sqarojmë të kaluarën. "Serbia refuzon të ballafaqohet me të kaluarën dhe unë bëj thirrje që në të gjitha tryezat e ndryshme që organizohen në arenën ndërkombëtare, nga Serbia pikësepari të kërkojmë hapja e arkivave. Meqenëse vrasja e shqiptarëve në pranverën e vitit '99, por edhe më herët në vitin '98 e

kështu me radhë, pastaj varrosja e tyre, zhvarrosja e tyre në Kosovë, bartja e kufomave nëpër varreza masive në Serbi dhe zhvarrimi prej atje. mandej gjithçka është bërë jo nga qytetarët e thjeshtë e të zakonshëm, por nga aparati shtetëror. Andaj, hapja e arkivave shtetërore në Serbi është përgjigja për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Ne si krerë të institucioneve do të jemi pranë familjarëve dhe gjithmonë do ta kemi prioritet këtë çështje", ka thënë kryeministri Kurti. Ndërsa kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se motrat, vëllezërit e fëmijët e pagjetur mbesin plagë e hapur, dhembje që vazhdon. Ata nuk kërkuar asgjë më shumë, vetëm se të jetojnë të lirë në shtëpinë e tyre, në dheun e të parëve. Zemra jonë bashkëndien me familjarët që ende presin të dashurit e tyre. Jemi gjithmonë bashkë!", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Kurse lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kërkuar që sa më shpejt të ndriçohet fati i personave të zhdukur.

**Në Kosovë krijohet një databazë për hetimin e krimeve të luftës**

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe Policia e Kosovës kanë zhvilluar një bazë të të dhënave për ta lehtësuar hetimin e krimeve të luftës dhe zhdukjeve me forcë. Në një deklaratë për media të EULEX-it është thënë se "kjo vegël u mundëson hetuesve që të organizojnë sasi të mëdha të të dhënave, të hetojnë raste komplekse dhe të ndërlydhura të krimeve të luftës dhe t'i përgatitin ato me sukses për ndjekje penale". "Baza e të dhënave ndihmon në ndërtimin e një rasti nga elementi kryesor i krimin, i cili mund të jetë një vend, një person ose një objekt. Ajo menaxhon një sasi të madhe të dhënash, si deklaratat e dëshmitarëve, dëshmitë mjekoligjore dhe informacione të hollësishme mbi datat dhe vendet



## Kurti: BE-ja ta bëjë zgjerimin më të drejtë dhe më të ndershëm

**PRISHTINË, 30 GUSHT (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar nga BE-ja që procesin e zgjerimit të bëjë më të drejtë dhe më të ndershëm. Në adresimin e tij virtual në Forumin Evropian "Alpbach 2021", në Austri, ai ka thënë se Kosova në procesin e integritimit evropian ka marrë më shumë

shkopinj se karota. "Politika e shkopinjve dhe karotave nuk ka qenë shumë frytdhënëse për Kosovën pasi kemi marrë shumë shkopinj, por jo shumë karota. Ka kaluar më shumë se një dekadë që kur të gjithë anëtarët e BP6 kanë marrë liberalizimin e vizave, ndërsa Kosova është ende duke pritur,

e izoluar si në një geto, imazh i cili sjell shumë turp në të dyja palët", ka thënë ai. Pamundësia për t'i hequr kufizimet e vizave për Kosovën dhe për t'i hapur negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, sipas kryeministrit, po shfaq nevojën për ta reformuar jo vetëm politikën e

zgjerimit, por edhe sistemin e vendimmarrjes së BE-së. Kurti ka deklaruar se BE-ja duhet t'i qartësojë pesë gjëra në raport me Ballkanin Perëndimor: ta krijojë një momentum të ri për reformat dhe ta bëjë zgjerimin më të drejtë dhe më të ndershëm, ta rrisë financimin, të marrë përgjegjësi për



kontinentin tonë, ta rrisë sinkronizimin midis Brukselit dhe Uashingtonit dhe ta përmbyllë ombrellën e sigurisë.



## 20 të vdekur dhe 932 raste të reja me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur 20 qytetarë të cilët kanë qenë të infektuar me Covid. Po ashtu, MSh-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 932 raste të reja me Covid. "Nga 7 384 testime, 932 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 20 raste të vdekjes. Sot janë shënuar 962 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 114 661. Në total numri i rasteve aktive është 26 525", ka njoftuar MSh-ja.

Ndërsa Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se në QKUK dhe në spitalet e Kosovës janë të shtrirë 1 250 pacientë, 1 142 janë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë, prej tyre 1 062 janë me oksigjenoterapi, 60 të tjerë në kujdes intensiv. "Në klinikat Covid të QKUK-së janë të shtrirë 438 pacientë, 435 prej tyre të konfirmuar me Covid-19, 376 me oksigjenoterapi. Në spitalet e përgjithshme janë të shtrirë 812 pacientë, 707 me Covid-19 pozitivë dhe 686 me oksigjenoterapi", ka njoftuar ShSKUK-ja.

## Drejtori i policisë kërkon angazhim për zbatimin e masave kundër Covidit

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, përmes platformës digjitale ka realizuar një takim zyrtar me zëvendës drejtorët, drejtorët e departamenteve, divizioneve, drejtorët rajonalë si dhe drejtorët e drejtorive, për të diskutuar rreth realizimit të objektivave dhe planifikimeve operacionale të policisë në lidhje me vendimet e fundit të institucioneve të Republikës së Kosovës për pandeminë Covid-19 si dhe tema të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me punën policore. Referuar vendimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës si dhe referuar planifikimeve operacionale policore, drejtori Mehmeti ka kërkuar nga eprorët policorë që të gjitha aktivitetet dhe masat e deritanishme të ndërmerren sipas vendimit të qeverisë në koordinim të plotë me të gjitha institucionet

kompetente në fushën e shëndetësisë dhe institucionet e tjera relevante, konform angazhimeve dhe detyrave sipas planit të paraparë. "Planifikimet operacionale kanë për qëllim bashkëpunimin e aktiviteteve me institucionet qendrore dhe lokale që janë kompetente për luftimin dhe parandalimin e rreziqeve nga virusi në fjalë si dhe përballjen me situatat e këtij lloji, në drejtim të koordinimit dhe reagimit me kohë. Me qëllim të respektimit të masave mbrojtëse, parandalimit të përhapjes së pandemisë, duke vënë në pah interesin e shëndetit publik, Policia e Kosovës, sipas planifikimeve, ka filluar me kohë realizimin e detyrave konkrete në gjithë territorin e Kosovës, duke aplikuar kontrolle të përbashkëta në trafik, në transportin e udhëtarëve, në qendra tregtare, lokale afariste, pika kufitare etj., përfshirë edhe shqiptimin e gjobave ndaj atyre që nuk



zbatojnë këto masa", ka njoftuar policia. Policia e Kosovës njëkohësisht u ka bërë thirrje qytetarëve, institucioneve dhe bizneseve, që

t'i respektojnë vendimet e fundit të marra nga qeveria e vendit, që t'u përmbahen rregullave dhe t'i respektojnë masat kundër Covidit, në mënyrë që edhe një

herë të arrijmë t'i ulim shifrat e të prekurve dhe të mbrojmë të gjithë së bashku shëndetin publik, në të kundërtën do të merren masa ndëshkuese.

## Kurti takon inspektorët e AUV-it: Po përballemi me variantin më të rrezikshëm të Covidit



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi dhe ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, ka zhvilluar takim me ushtruesin e detyrës së kryeshefit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Flamur Kadriu dhe inspektorët e kësaj agjencie. Zyra e kryeministrit Kurti ka njoftuar se takimi është zhvilluar një ditë pas mbledhjes urgjente të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për shkak të përkeqësimit të gjendjes së pandemisë. Kryeministri Kurti i ka njoftuar inspektorët për vendimet nga ai takim dhe ka folur për rëndësinë e zbatimit të masave kundër pandemisë të marra në

mbledhjen e 32-të të qeverisë. Ai ka thënë se "kemi hyrë në një fazë të re të mbikëqyrjes së zbatimit të masave dhe se zbatueshmëria e tyre u jep masave legjitimitet, përveçse siguron efektshmërinë e tyre". "Aktualisht po përballemi me variantin më të rrezikshëm të virusit, atë 'Delta', andaj në një situatë që nuk është e zakonshme, nuk mund të sillemi si zakonisht. Angazhimi i gjithsecilit duhet të jetë një që s'e kemi bërë më parë", ka thënë kryeministri Kurti. Ndryshe, Kurti ka njoftuar të dielën se do të shtojnë numrin e inspektorëve për t'i zbatuar masat e reja kundër Covidit. "Nga 17 inspektorë do t'i shtojmë edhe 85 inspektorë", ka deklaruar Kurti.



# Refuzimi i tregut me miliona konsumatorë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Refuzimi i institucioneve të Kosovës për të qenë pjesë e iniciativës “Ballkani i Hapur” është duke bërë që vendi ta humbë mundësinë që t’i bashkohet një tregu më të gjerë konsumues si dhe po pamundësohen investime ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor, ka thënë profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu.

Iniciativa “Ballkani i Hapur” është vazhdimësi e “mini-Shengenit” ballkanik, e prezantuar në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019 nga liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

Tre liderët e këtyre shteteve, Aleksandar Vuçiq, Zoran Zaev dhe Edi Rama, atëbotë kishin nënshkruar edhe deklaratën e “mini-Shengenit”, e cila bazohet në katër liri themelore: lëvizja e lirë e mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve.

Kjo nismë parasheh kalimin e kufijve të qytetarëve duke përdorur vetëm letërnjoftimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pengesave në vendkalimet kufitare, zvogëlimin e pengesave ekonomike, rritjen e turizmit brenda rajonit, tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe lehtësi të tjera.

Duke filluar nga 1 janari i vitit 2023, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut synojnë të heqin kontrollin në kufijtë e tyre për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave.

Kosova ka refuzuar të jetë pjesë e kësaj marrëveshjeje pavarësisht se është zotuar që do t’i bashkohet iniciativës së “mini-Shengenit” përmes Marrëveshjes së Uashingtonit, të nënshkruar më 4 shtator 2020 në Shtëpinë e Bardhë. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr

nga Albin Kurti, mendon se iniciativa e “mini-Shengenit” është nismë pa vizion për rajonin.

Kjo iniciativë nuk po përkrahet as nga partitë opozitare - Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

## Gërxhaliu: Po humbet një treg prej 14 milionë konsumatorësh

Por, profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, në një bisedë për “Radion Evropa e Lirë” ka thënë se Kosova nuk ka komoditet për politika refuzuese ndaj nismave që kanë për qëllim integrimin rajonal ekonomik. “Që nga viti 1999, me Paktin e Stabilitetit ka pasur iniciativë të njëjta që kanë pasur një qëllim: përgatitjen e Ballkanit Perëndimor për të qenë pjesë në familjen evropiane. Në këtë drejtim edhe CEFTA (Marrëveshja për Tregti të Lirë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor) dhe Procesi i Berlinit kanë luajtur rol të rëndësishëm në këtë rrugëtim. Në këtë drejtim nuk duhet të cenohet rrugëtimi në familjen evropiane. Duhet të jemi pjesë e tyre. Nuk duhet të jemi të humbur”, ka thënë Gërxhaliu.

Kosova është në një pozitë të pafavorshme në tregun rajonal. Deficiti i lartë tregtar përbën një sfidë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Gjatë vitit 2020 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia) arritën në 210.7 milionë euro, ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në



vitin 2020 arritën në 615.3 milionë euro.

Një hulumtim që ka bërë Organizata Joqeveritare Demokracia për Zhvillim ka vënë në pah se në Ballkanin Perëndimor çdo iniciativë rajonale duhet të ketë aprovimin dhe bashkëpunimin nga gjashtë shtetet në mënyrë që iniciativat rajonale të jenë efektive.

Në deklaratën e “mini-Shengenit”, sipas këtij hulumtimi, lista e katër lirive të vendosura jep përshtypjen se biznesi dhe tregtia janë prioritetet kryesore. Sipas këtij hulumtimi, kjo është problematike për Kosovën, qytetarët e së cilës ende ballafaqohen me mungesën e lirisë së lëvizjes dhe kanë shumë vështirësi për t’u pajisur me viza për të udhëtuar jashtë vendit.

## Më shpejt e më lehtë në tregun rajonal

Iniciativa “Ballkani i Hapur”, e cila, përveç të tjerash, do ta mundësonte lëvizjen e lirë të mallrave, po mbështetet nga kompania “Frutex” nga Suhareka, e cila është e shtrirë me produkte në vendet e Ballkanit Perëndimor. “Për kompaninë tonë do të ishte një lehtësim, pasi që do të mundësonte që në të njëjtën kohë produktet tona t’i plasojmë edhe në Shkup, edhe në Podgoricë, edhe në Tiranë, pse jo edhe në Beograd, ndonëse ka paragjykimet për produktet ‘Made in Kosova’. Por, edhe atje do të mundemi, pasi që jemi prezent në Sanxhak dhe Luginën e Preshevës. Do ta lehtësonte të bërit biznes duke hequr shumë barriera jotarifore.

Do të mundësonte më shpejt dhe më lehtë qasjen në këto tregje”, ka thënë pronari i kësaj kompanie, Shaqir Palushi.

Bashkimi i Kosovës në këto iniciativë rajonale, shton Palushi, është një rrugë që domosdoshmërisht duhet ta kalojë Kosova për të qenë pjesë e integritit në BE. Iniciativat që kanë përkrahjen e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara, sipas tij, në aspektin ekonomik mund të kenë dobi.

Ndërkohë Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë konfirmuar se mbështesin përpjekjet e Ballkanit Perëndimor për ta forcuar integrimin ekonomik. Ata i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që t’u qaset me “mendje të hapur” përpjekjeve për integrim rajonal ekonomik.

# Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ndan 3.65 milionë euro grante



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka njoftuar se ka lansuar tri grante për përkrahje të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme. Në një konferencë për media, ministrja Rozeta Hajdari ka theksuar se qëllimi i këtyre granteve që kapin shumën prej 3.65 milionë eurosh është për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e eksporteve. “Për sa i përket granteve, MINT-i ka ndarë grante në vlerë prej 3 milionë e 650 mijë eurosh për tri grant-skema. Përmes këtyre kemi për qëllim ta përkrahim veprimtarinë e sektorëve që kanë ndikim në krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik, duke fuqizuar në këtë rast sektorin privat përmes ndërmarrjeve mikro dhe të vogla”, ka thënë Hajdari. Sipas saj, ndërmarrjet


prodhuese, përpunuese dhe të eksportit janë fushëveprimtaritë që do të përkrahen.

“Fushëveprimtaritë që do të përkrahen janë ato prodhuese, përpunuese dhe të eksportit. Ndërmarrjet në sektorin privat të tekstit, produkteve të plastikës, ndërmarrjet në sektorin e prodhimit dhe sektorët e tjerë shërbyes”, është shprehur ajo.


Hajdari ka thënë se bizneset “start-up” gjithashtu do të përkrahen. “Ne do të përkrahim edhe bizneset fillestare, ato ‘start-up’, të themeluar në tre muaj apo tre vjet”, është shprehur Hajdari, duke shtuar se rritja e punësimit të grave dhe personave me nevoja të veçanta është kriter për të gjitha kategoritë për këto tri grant-skema.

Në fund Hajdari ka njoftuar se për aplikim duhet të kyçen në platformën “e-Kosova”.




**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
 Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South



Nr. ifaq./Broj: 12-11/01-0073886/21  
 Data/Datum: 30.08.21

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, Nenit 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit të punës Nr. 03/L-2012, Nenit 17 paragrafi 1 të ligjit për Teatro Nr.04/L-106 dhe udhëzimit administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik Komuna Mitrovica e Jugut shpall:

**KONKURS**

**Për plotësimin e stafit në Teatrin e Qytetit „Muharrem Qena”**

**Institucioni:** DKRS/ Teatri, „Muharrem Qena” Mitrovicë

**1. Titulli i pozitës:** Përgjegjës për skenën e të rinjëve dhe fëmijëve

- Nr i pozitave :1 (Një)
- Grada /koeficienti 7.00
- I përgjigjet: Drejtorit të përgjithshëm
- Orari i punës : 1 plotë 40 orë në javë

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

Të organizoj mbajtjen e provave të shfaqjeve të rinjëve dhe fëmijëve;

- Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- Të diskutojnë dhe organizojnë me kreativitet;
- Të bashkëpunojnë me shkollat të mesme dhe të ulëta për angazhimin e nxënësve në aktivitete teatrore;
- Të kujdesen për hapësirën përformuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e roleve;
- Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit në bashkëpunim me Udhëheqësin artistik.
- Për punën e tij/saj i përgjigjen Drejtorit të përgjithshëm të Teatrit.

**Kualifikimi dhe shkathtësit e kërkuara;**

- Pregaditja Universitare ( Diploma e Universitare)
- Tri vite përvojë pune.
- Njohja e punës praktike administrative.
- Aftësi të mira menaxheriale.
- Aftësi të mira në komunikim verbal dhe të shkruar.
- Te ket njohuri të mira për funksionimin e Teatrit si institucion dhe art.
- Të jet i/e motivuar ,profesional dhe qasje pozitive.
- Njohuri e punës me kompjuter,word,excel etj.
- Të jetë fleksibil/e dhe krativ/e duke marrë parasysh edhe kriteret e vështirsuara të punës.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Të gjithë të pranuarit përmes Konkursit publik, marrin kontrata të përhershme pas periudhës provuese 6 mujore , sipas suksesit dhe angazhimit të treguar të paraparë me Rregulloret e sipërcekura.


**Dokumentacioni i kërkuar:** •Diploma (Kopja e noterizuar) • fotokopja e Letërnjoftimit , ekstrakti i lindjes , rekomandime apo certifikata për pozitën në të cilën aplikoni nëse keni, dëshmit mbi përvojën e punës , certifikatën që nuk jeni nën hetime.


**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 10 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe të bashkëngjiten këto dokumente: Diploma mbi kualifikimin, fotokopja e letërnjoftimit; ekstrakti i lindjes, dëshmi mbi përvojën e punës, certifikata që nuk jeni nën hetime dhe certifikata që dëshmojnë njohuri nga fusha përkatëse. Dokumentet duhet të jenë në njërin prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 028 – 532 104 dhe 028 535 559.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.


**Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit**

z.Agim Bahtiri  
 Kryetari i Komunës Mitrovica e Jugut

  
 Mitrovicë 30.08.2021


**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
 Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South



Nr. ifaq./Broj: 12-11/01-0073886/21  
 Data/Datum: 30.08.21

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, Nenit 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit të punës Nr. 03/L-2012, Nenit 17 paragrafi 1 të ligjit për Teatro Nr.04/L-106 dhe udhëzimit administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik Komuna Mitrovica e Jugut shpall:

**KONKURS**

**Za popunjavanje osoblja Gradskog Pozorišta „Muharrem Qena”**

**Institucija:** UKOS/ Pozorište,„Muharrem Qena” Mitrovica

**1. Naziv pozicije:** Odgovoran za scenu mladih i dece

- Br. pozicija :1 (jedna)
- Stepen /koeficijentat 7.00
- Odgovara: Generalnom direktoru
- Radno vreme: Puno, 40 časova nedeljno

**Zadaci i odgovornosti:**

- Da organizuje probe predstava za decu i mlade,
- Da istraži i čita materijale ili preduzma fizičke i intelektualne aktivnosti koje pomažu u pripremi njihovih uloga ,
- Da diskutuje i organizuje sa kreativnošću,
- Da sarađuje sa srednjim i nižim školama o angazovanju učenika u pozorišnim aktivnostima,
- Stara se o prostoru za predstavu, kostimima i rekvizitima,
- Da prouči akcije i rad na stvaralački način o umetničkom životu u pripremi uloga,
- Da sarađuje direktno sa režiserom predstava,
- Izvršava i ostale zadatke na zahtev direktora Pozorišta uz saradnju sa Umetničkim rukovodiocem.
- Za svoj rad odgovara Direktor Pozorišta.

**Potrebna kvalifikacija i sposobnosti;**

- Univerzitetska sprema ( Diploma Fakulteta)
- Tri godine stručnog radnog iskustva
- Poznavanje praktičnog administrativnog rada
- Dobre menadžerske sposobnosti
- Dobra sposobnost pisane i usmene komunikacije.
- Da ima dobro znanje o funkcionisanju Pozorišta kao institucije i umetnosti.
- Da bude motivisan/a, stručan/a i da ima pozitivan pristup.
- Poznavanje rada na kompjuteru,word,excel itd.
- Da bude fleksibilan i kreativan uzimajući u obzir teške kriterijume rada.

**Uslovi učesća na konkursu:** Pravo na prijavu imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost da deluju i koji imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za izvršenje zadatka.

**Trajanje imenovanja:** Svi primljeni preko Javnog konkursa, dobijaju trajne ugovore nakon probnog rada od 6 meseci, u skladu sa uspehom i zalaganjem prikazanim gore navedenim propisima.


**Zahtevana dokumentacija:** •Diploma (Overena kopija) • fotokopija Lične karte, izvod iz matične knjige rođenih, preporuke ili certifikati za određene gore navedene oblasti za radno mesto na kome se prijavljujete, dokazi o radnom iskustvu, potvrda da niste pod istragom.

**Podnošenje zahteva:** Prijave se primaju i i podnose u kancelariji br. 10 u Opštini Južna Mitrovica. U prijavi treba jasno da se navede naziv radnog mesta i referentni broj i dodaju sledeći dokumenti: diplome o kvalifikaciji, fotokopija lične karte; izvod iz matične knjige rođenih; dokaz o radnom iskustvu; uverenje da nije pod istragom i certifikati koji pokazuju znanje iz odgovarajuće oblasti. Dokumenti moraju biti na jednom od zvaničnih jezika opštine. Možete uspostaviti telefonske kontakte na 028 - 532 104 i 028 515 559.

Prijave poslate nakon poslednjeg datuma i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

**Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja**

g.Agim Bahtiri  
 Predsednik Opštine Južna Mitrovica

  
 Mitrovica 30.08.2021



# Pandemitë do të jenë gjithnjë e më të shpeshta, ndaj duhet të përgatitemi

Pandemitë janë gjithnjë e më të shpeshta dhe të mundshme. Në këtë përfundim ka mbërritur një ekip ndërkombëtar studiuesish gjatë një studimi të botuar në revistën "PNAS" dhe të kryer nga Universiteti i Padovës.

Sipas tyre probabiliteti që një pandemi si ajo e Covid-19 të shfaqet në çdo moment dhe gati çdo vit është tani për tani rreth 2 për qind. Por studiuesit paralajmërojnë se tendenca po rritet, dhe se ajo mund të 3-fishohet në dekadat e ardhshme.

"Frekuenca me të cilën po shfaqen sëmundje të reja epidemike nga bota e kafshëve, është rritur ndjeshëm gjatë dekadave të fundit, dhe kjo për shkak të ndryshimeve antropogjene të mjedisit"- shpjegon Marko Marani, kreu i studimit, që shtoi se njerëzimi nuk

është ende i përgatitur për epidemitë me intensitet të madh, të cilat nuk janë gjithsesi të pamundura 400 vjet histori. Për studimin, studiuesit analizuan të dhënat nga 4 shekujt e epidemive të mëdha (1600-2020). Gripi spanjoll e ka rikonfirmuar veten si pandemia më serioze në historinë e njerëzimit. Vlerësimet e të vdekurve, ku thuajse të gjithë janë të pasakta, variojnë midis 50 dhe 100 milionë njerëzve.

Në çdo rast, një masakër e vërtetë, duke pasur parasysh se në atë kohë popullsia e botës nuk arrinte as 2 miliardë njerëz. Intensiteti i epidemisë spanjolle, i përcaktuar nga autorët si numri i viktimave i ndarë me kohëzgjatjen e epidemisë, dhe i krahasuar në lidhje me popullsinë botërore të kohës, ishte rreth 5.7 për 1 mijë në vit. Për krijuar një ide se çfarë tregon kjo, Covid-19 ka treguar

deri më tani një intensitet prej 0.3 viktimave për 1 mijë në vit, pra rreth 20 herë më pak.

## Skenarë pak a shumë të mundshëm

Shanset që një pandemi me intensitetin e Gripit Spanjoll të shfaqet sërish janë midis 0.3-1.9 për qind në vit, për periudhën e studiuar. Pra me fjalë të tjera, duke folur me aspektin statistikor ka të ngjarë që një "Grip Spanjoll 2.0" të mbërrijë nga tani dhe deri 400 viteve të ardhshme.

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që ne mund të jemi të sigurt për të paktën 3 shekuj. Një virus i tillë vdekjeprurës mund të zhvillohet brenda 2, 10, 100 apo 200 vjetësh, me të njëjtën probabilitet. Ndërkohë për një "Covid 2.0", mund të na duhet të presim vetëm 59 vjet, sërish sipas të



dhënave statistikore. Pra me pak fjalë, ka shumë të ngjarë që një pandemi tjetër të na prekë gjatë jetës sonë, të fëmijëve apo nipërve dhe mbesave tanë.

Ndërkohë studimi llogariti mundësinë e një pandemie që mund ta shfarosë tërësisht

njerëzimin nga faqja e Tokës. Një pandemia e tillë ka të ngjarë të ndodhë brenda 12.000 viteve të ardhshme. Por siç e thamë më lart, kjo nuk do të thotë se nuk mund të ndodhë për 1, 10, 200, 1.000, apo 3 mijë vjetësh... / Focus - Bota.al

## Pse vendet e BE-së kanë detyrimin moral t'i ndihmojnë refugjatët afganë

Nga Malia BOUATTIA  
"The New Arab"

Qëndrimi i vendeve evropiane në raport me mbështetjen e refugjatëve që po largohen këto ditë nga Afganistani, për shkak të rimarrjes së kontrollit të vendit nga talebanët, mund të mashtrojë cilindo të mendojë se ato nuk kanë asgjë përgjegjësi në krizën politike aktuale.

Dy dekadat e fundit pas pushtimit të Afganistanit kanë lënë pas gjurmët e vdekjes, destabilitetit dhe shkatërrimit. Nuk është për t'u habitur, që ato e kanë shtuar mosbesimin ndaj SHBA-së dhe aleatëve të saj - Britanisë dhe gjithë Evropës - të cilët e justifikuan atëluftë bazuar në premisën se ajo do ta transformonte pozitivisht Afganistanin, dhe do të çrrënjoste terrorizmin prej andej.

Por e gjitha kjo është zhdukur nga narracioni publik. Në vend të saj, brenda pak ditësh nga fitorja e talebanëve, nisën të shfaqen deklaratat e vendeve evropiane që bënin thirrje për kontrollin e flukseve dhe kufijve. Larg marrjes së përgjegjësisë dhe trajtimit të pasojave të një sipërmarrjeje imperialiste, që deri më sot i kanë marrë jetën mbi 100.000 njerëzve, udhëheqësit perëndimorë u përpoqën t'i mbyllnin kufijtë kombëtarë dhe t'i përforconin ato. Që në fillim të muajit gusht, teksa talebanët po fitonin me shumë shpejtësi terren, Austria, Belgjika, Danimarka, Greqia, Gjermania dhe Holanda i kërkuan përmes një letre të përbashkët Komisionit Evropian që të vazhdojë me deportimet e emigrantëve afganë,

që iu është refuzuar kërkesa për azil.

"Ndalimi i këtij procesi dërgon sinjalin e gabuar, dhe ka të ngjarë të motivojë edhe më shumë qytetarë afganë të largohen nga shtëpitë e tyre për të ardhur këtu në BE"- paralajmëruan ata. Fiksimi për t'i mbajtur afganët jashtë Evropës, vazhdoi edhe pasi talebanët pushtuan kryeqytetin Kabul.

Presidenti francez Emanuel Makron njoftoi se Franca, Gjermania dhe shtetet e tjera të BE -së po bashkojnë forcat për t'u përballur me "flukset e parregullta migratore" që po parashikonin udhëheqësit botërorë.

Për më tepër, gjatë një fjalimi televiziv drejtuar kombit, Makron nuk humbi kohë që t'i bëjë të qarta prioritetet e Francës, kur deklaroi se vendi i tij duhet të "parashikojë dhe ta mbrojë veten nga një valë emigrantësh".

Po ashtu ai i përshkroi ngjarjet në Afganistan si një "sfidë të rëndësishme për sigurinë tonë". Ndërkohë siguria e afganëve nuk u përmend në asnjë rresht të deklaratës. Aq më tepër pas më shumë se një dekadë të pranisë ushtarake franceze në këtë vend.

Edhe premtimi i Makron për t'i mbështetur refugjatët dukej i kushtëzuar, kur ai përmendi afganët që ishin lejuar tashmë të hyjnë në Francë, për shkak se më parë kishin punuar me ushtrinë franceze në Afganistan. "Është në detyrimin por dhe në dinjitetin tonë të mbrojmë ata që na ndihmojnë: përkthyes, shoferë, kuzhinierë dhe shumë të tjerë".

Pra shteti francez është i angazhuar të bëjë dallimin midis



"emigrantit të mirë" që mbështet përpjekjet ushtarake të Francës dhe "emigrantit të keq", që kërkon një jetë më të mirë jashtë shtetit, pikërisht në vendin që mori pjesë në shkatërrimin e atdheut të tij.

Mbrojtja që po u jepet atyre që ikin tani, ka të ngjarë të jetë gjithashtu e kushtëzuar nga kategoria në të cilën bëjnë pjesë ata. Për më tepër, fjalimi i tij u transmetua në media vetëm disa orë pasi qarkulluan videot dhe imazhet e afganëve që binin nga avionët ushtarakë, të kapur dëshpërimisht pas krahëve të tyre me shpresën e largimit me çdo kusht nga vendi.

Ky është niveli i konsideratës që mund të presin afganët nga shteti francez, dhe fatkeqësisht edhe nga shumë shtete të tjera në kontinentin evropian. Meraku i shprehur nga udhëheqësit perëndimorë, e thekson më tej faktin se ndërhyrja nuk ishte e motivuar nga shqetësimi për civilët.

Në realitet, afganët e kanë përjetuar dhunën e kufijve perëndimorë gjatë 20 viteve të fundit. Diaspora afgane ka kohë që është keqtrajtuar dhe diskriminuar nga "Fortesa Evropë", e cila i ka kriminalizuar, ndaluar dhe dëbuar. Për shembull, Britania ka refuzuar mbi 32.000 azilkërkues afganë që nga pushtimi i vendit në vitin 2001.

Mbi 600 njerëz të ardhur nga Afganistani si të mitur të pashoqëruar, u dëbuan nga Zyra e Brendshme midis viteve 2009-2015. Në këto kushte, deklarata e Sekretarit të Jashtëm Dominik Rab se Britania "ka qenë gjithnjë një vend, që i ka siguruar një strehë të sigurtatyre që i ikin persekutimit" është boshe.

Kjo histori, bën që edhe angazhimi i qeverisë britanike për të pranuar 20.000 refugjatë afganëpërgjatë disa viteve të ardhshme të duket i pavlerë. Sipas parashikimeve të UNHCR-së deri

në 3.5 milionë afganë, mund të zhvendosen brenda vendit.

Ndërkohë plani i zhvendosjes i qeverisë Xhonsen, që përcakton se vetëm 5,000 afganë do të pranohen gjatë vitit të parë të programit, është mjerisht i papërshtatshëm. Mospërfillja e përgjegjësisë, zhvendosja e fajit dhe taktikat e distancimit, kanë të ngjarë që të vazhdojnë midis vendeve më të fuqishme.

Takimi i fundit G7-ës i kryesuar nga Britania, diskutoi vendosjen e talebanëve para përgjegjësisë për "veprimet e tyre në parandalimin e terrorizmit, në të drejtat e njeriut, në veçanti, ato të grave, vajzave dhe pakicave, dhe në ndjekjen e një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse politike në Afganistan".

Por ndërkohë nuk pati asnjë përmendje të rolit të tyre në përkeqësimin e të gjitha këtyre problemeve që janë krijuar gjatë 20 viteve të fundit. Prandaj është e domosdoshme që ne t'i vëmë para përgjegjësisë këto vende, në mënyrë që t'u bëjmë presion jo vetëm të pranojnë, por edhe të mbështesin në mënyrë të duhur refugjatët afganë.

Po ashtu është vendimtare që leksionet e luftës në Afganistan, të cilat u kundërshtuan nga miliona aktivistë kundër luftës në të gjithë botën, të mos "fshihen më nën qilim". Në rast se shtetet tona nuk merakosen për fatin e njerëzve të shtypur - brenda apo jashtë vendit - ndërhyrjet e tyre nuk do të udhëhiqen kurrë nga shqetësimet humanitare.

Shënim: Malia Bouattia është aktiviste, ish-presidente e Unionit Kombëtar të Studentëve në Britaninë e Madhe. Bota.al





## K O N K U R S

- Të shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- **Pozita e punës:** Zyrtar/e i/e Burimeve Njerëzore
- **Numri i pozitave:** 2 (dy)
- **Kohëzgjatja e punës:** 1 vit me mundësi vazhdimi
- **Paga bruto:** Në bazë të Rregullores për Paga.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për punët organizative të burimeve njerëzore (BNJ), përgatitë procedurat për rekrutim të personelit gjatë vitit kalendarik në harmoni me kërkesat e menaxhmentit të TU.
- Përgatitë procesin e intervistimit të kandidatëve, listën e kandidatëve për intervista, listën për testim dhe listën e shpalljes për kandidat të përzgjedhur.
- Mbanë përgjegjësi për dosjet e punëtorëve si dhe mban ne konfidencialitet të plote dosjet e secilit të punësuar në TU.
- Pranon fletëparaqitjet disiplinore dhe i dërgon tek komisioni disiplinor, ndihmon komisionin disiplinor në përgatitjen e rasteve dhe nxjerrjen e provave, njëherit shërben edhe si sekretar teknik i komisionit.
- Përgatitë dhe procedon procedura, duke u bazuar në rregullat e brendshëm, ligjeve përgatite procedurat për masë disiplinore për të gjithë punëtorët e TU që shkelin rregullat e punës sipas rregullave, procedurave dhe ligjeve që janë në fuqi.
- Përpunon të gjitha të dhënat statistikore që janë relevante me administrim të personelit në nivel të TU.
- Përgatitë programin e trajnimeve për stafin e TU, përgatite plane, mujor dhe vjetor për burimet njerëzore.
- Punon në bazë të procedurave të administrimit të personelit, propozon hartimin e procedurave për administrimin e personelit,
- I përgatit kontratat e punës për të gjithë punëtorët e TU, i përgatit vendimet për pushim vjetor, i përgatit kartelat e identifikimit për punëtorët e TU, në bashkëpunim me Sekretarin e ndërmarrjes.
- Azhuron punët në dosjet e punëtorëve dhe punët në modulën e Burimeve Njerëzore, mbanë evidenca për pushimet e punëtorëve të përcaktuar sipas Ligjit të Punës në fuqi.
- Ndihmon në përgatitjen teknike të trajnimeve konform rregullores së brendshme të trajnimeve për stafin e TU.
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Sekretari.

### 1. Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në Juridik, Administratë Publike apo Shkenca Sociale;
- Përvojë pune në Burime Njerëzore së paku 1 vit të dëshmuar edhe përmes Trust-it.
- Njohuri të mira rreth Ligjit të Punës, identifikimin e nevojave për trajnime dhe organizimin e tyre, organizimi i stafit, identifikimi i nevojave të stafit që lidhen me natyrën e punës, përpilimi i shkresave dhe aftësi analitike etj..
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft Office (Word, Excel, Outlook).
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

### 2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com):
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;
- Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

### Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)  
Konkursi është i hapur nga data **31.08.2021** dhe përfundon më datë **14.09.2021** në ora 24:00

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

2



**MITROVICA**  
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

**D P A**

Departamenti për punë administrative

Mitrovicë / Nr.

Duke u bazuar ne Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017, dhe vendimin e Bordit të Përkohëshëm të Drejtorëve të datës 25.08.2021, Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, me datën 30.08.2021 shpallë:

## K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës, punë provuese 6 muaj me mundësi vazhdimi)

### I. (1) Shef i Kontabilitetit

#### Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës:

- Bënë kordinimin e punëve të dokumentacionit financiar të të tri njësjive (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj),
- Bënë pranimin e dokumentacionit dhe shikimin e rregullsisë së tij,
- Kryen regjistrimin e tërë dokumentacionit në librat e kontabilitetit,
- Kryen regjistrimin e ekstrakteve bankare në librat e kontabilitetit nga bankat ku kompania ka llogarit e hapura si dhe barazimi i tyre me librat e kontabilitetit,
- Pranimin e faturave hyrëse, regjistrimin e tyre në kontot adekuate nëpër njësitë përkatëse,
- Pranimin e faturave dalëse si ato të shërbimeve, të ujit, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit,
- Përcjellja e arkës për njësi, arkat e inkasimit ditor dhe arkën e shpenzimeve, për secilën njësi arkat e të hyrave dhe shpenzimeve, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit, barazimi i inkasimeve ditore me shërbimin e inkasimit,
- Përpilimin e raporteve financiare mujore, llogaritja e TVSH-së, plotësimi dhe deklarimi mujor i TVSH-së,
- Plotësimi dhe deklarimi i formularëve të tatimit në burim,
- Plotësimi dhe deklarimi i formularëve për kontribute,
- Raportet tremujore në të ardhurat e kompanis dhe dorëzimi i tyre në ATK,
- Përpilimi i pasqyrave financiare në bashkëpunim me ZKF si dhe punët plotësuese me urdhër të Kryeshefit Ekzekutiv,
- Përgatitja e dokumentacionit për Auditim të jashtëm si dhe bashkëpunimi me Auditor të Jashtëm,
- Kryen punë dhe detyra tjera sipas Udhëheqësit.
- Përgatitja superiore – Fakteti Ekonomik,
- Të jetë Kontabilist i/e certifikuar (obligative),
- Së paku 3 vite përvojë pune në menaxhim,
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe Zyrtarët e Lartë tjerë të Kompanisë.

Dokumentat e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letren përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, dëshmin që është Kontabilist i certifikuar, referencat dhe certifikatat- të lindjes, shëndetësore, të mos jetë nën hetime dhe i denuar, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njejtë nuk u kthehet aplikantëve.

Aplikacionet merren dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Drejtorin e KRUM-së.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit në të përditshmen Epoka e Re.

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në:

Drejtorinë e KRUM-së.

Rr., Liqeni,...

Suhodoll-Mitrovicë



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



# 22 'mega-shkatërrimet' 22-vjeçare që përfundimisht 'fundosën' Kosovën



**Shkruan: Agron HOTI**

Kosova për 22 vjet çlirim është sulmuar në mënyrë aq brutale nga brenda dhe jashtë (kryesisht nga masa subversive serbe e ruse dhe aleatë të tyre duke i fryrë zjarrit të përgatjes ekstreme jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri) për të krijuar realitet artificial me qëllim demoralizimi të masave të gjera popullore se, kinse, këtu po vdisnin njerëzit urie, kjo në kohën kur standardin jetësor që kemi sot kurrë në histori s'e kemi pasur dhe kur mbipesha nga ushqimi me bollëk është bërë problem kombëtar. E kur situata do të arrijë të qetësohet dhe njerëzit ta kuptojnë hilen e madhe që po i përgatitej Kosovës në maskën e "shpëtimit", do të jemi dëshmitarë të gjallë që Kosova për 22 vjet çlirim dhe vetëm 13 vjet shtetësi ka arritur 22 "mega-shkatërrime", bile më shpejt se çdo shtet në botë në moshën 13-vjeçare. E 22 "mega-shkatërrimet" që e 'fundosën' Kosovën janë si më poshtë:

1. Kosova ka arritur që për një periudhë prej më pak se 2 apo 3 vjet pas luftës ta përfundojë rindërtimin e të gjitha shtëpive dhe vendbanimeve të shkatërruara duke zhdukur kështu çdo gjurmë të luftës. Këtu kontribut të madh ka dhënë mërgata jonë, ndihmat ndërkombëtare si dhe zelli i qytetarëve për t'iu kthyer tokës mëmë. Më poshtë se shkumbi e hiri i vitit 1999 nuk kishte ku të shkojë Kosova. Bosnja e Hercegovina edhe sot nuk i ka zhdukur gjurmët e luftës. As Evropa s'ka arritur t'i zhdukë gjurmët e Luftës së Dytë Botërore më shpejt sesa Kosova. Ky është fakt;

2. Edhe pse Kosova gjatë periudhës 1999-2007 ende s'ishte bërë shtet, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, përkundër pengesave serbe dhe ruse, kishte arritur të bëhej pjesë e të gjitha nismave, organizatave dhe mekanizmave rajonale si palë e barabartë me Serbinë, Bosnjën e Hercegovinën dhe tërë rajonin. Anëtarësimi në CEFTA (viti 2007) dhe në Traktatin e Energjisë për Evropën Juglindore (2006) etj. ishin shembujt më tipikë të integritimit rajonal;

3. Politika e Kosovës nga 1999-2008 ka punuar ngushtë me ShBA-në dhe BE-në për ta shpallur pavarësinë e njohur nga mbi 110 shtete të botës. Kush e mendon që ka qenë e lehtë tërë

kjo mega-ndërmarrje ndërkombëtare për të cilën kanë vdekur miliona shqiptarë, e ka ngatërruar planetin. E bashkësia ndërkombëtare e ndihmoi politikën tonë, sepse i besonte që ta shpallte pavarësinë e ëndërruar me shekuj dhe të fillonte shtetndërtimin e Kosovës. Falë kësaj pavarësie sot njerëzit në Kosovë jetojnë të lirë dhe më mirë se çdo herë në historinë mbi dymijë vjeçare të Kosovës;

4. Kosova gjatë periudhës 2008-2019 si asnjë shtet deri me sot në botë ka arritur që për një afat rekord ta kompletojë tërë mozaikun kushtetues, ligjor dhe institucional brenda dhe jashtë saj, e tëra kjo edhe falë bashkëpunimit me SHBA dhe BE. Fakti që pushtetet në Kosovë e njohin dhe pranojnë tërë këtë mozaik bile edhe e lavdërojnë e konfirmon mega-arritjen e Kosovës. Të marrësh Kosovën e vitit 2021 të gatshme me tërë mozaikun kushtetues, ligjor, institucional si dhe bazë solide të zhvillimit ekonomik është dhurata më e madhe për ata që sot e gëzojnë, por që mundohen t'i heshtin me çdo kusht. Fakti që institucionet e Kosovës, më të rejtat në botë, kanë arritur që përkundër vështirësive të plotësojnë dyfishin e kriterëve që kishte rajoni për CEFTA, Traktat të Energjisë, MSA, liberalizimi të vizave etj. gjithnjë sipas Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian e konfirmon më së miri arritjen e madhe institucionale. Fakti që sot Forcat e Armatosura të Kosovës marrin pjesë nëpër misione ndërkombëtare flet vet që Kosova ka shënuar të arritura të jashtëzakonshme, e kjo arritje u bë pikërisht nga institucionet e Kosovës të mbështetura nga SHBA e BE;

5. Kosova edhe pa qenë shtet 1999-2007 edhe pasi është bërë shtet 2008-2021 ka arritur të organizojë zgjedhje demokratike në nivel lokal dhe qendror të pranuar dhe lavdëruara ndërkombëtarisht si shembull për tërë rajonin. Vetë fakti se tranzicionet dhe rotacionet politike kanë ndodhur pa kurrfarë dhune e telashe e konfirmon progresin e Kosovës drejt demokracisë më shpejtë se çdo vend në rajon, ndaj kjo hedh plotësisht poshtë çdo pretendim për kapje shteti, se përndryshe pushtetet s'do të mund të ndërroheshin pa dhunë e çmendurira siç shpesh kishte ndodhur në rajon dhe botë. Në shtete të kapura s'mund të zhvillohet siç është zhvilluar në Kosovë industri e paparë mediale e fjalës së lirë, sindikata e shoqëri civile më të konsoliduara se në çdo shtet në rajon. Ka liri mediale më shumë se në çdo shtet të rajonit, ndaj edhe kjo hedh poshtë

çdo pretendim se mediat e shoqëria civile dhe sindikatat ishin të kapura;

6. Kosova që nga viti 1999 deri në 2021 nuk ka pasur as edhe një herë të vetme trazira socio-ekonomike, të cilat do të mund ta konfirmonin varfërinë ekstreme siç mundoheshin ta paraqisnin oportunistët e qarqet dashakeqe duke lypur me llupë vetëm pikat e dobëta e duke heshtur qëllimshëm të fortat. Fakti që sipas Bankës Botërore Kosova ka pasur rritjen ekonomike më të madhe në rajon gjatë periudhës 2008-2019 tregon më së miri se pse nuk ka pasur trazira socio-ekonomike. Fakti që Kosova që nga 1999 deri në 2021 ka pasur rritjen ekonomike më të madhe në Evropë dhe pse jo më stabilen prej plus minus 4 për qind (sipas Rushir Scharma). Fakti që Kosova e pati kaluar krizën financiare globale të vitit 2008 pa trazira socio-ekonomike siç patën ndodhur në Greqi e vende tjera të BE-së flet shumë për zhvillimin ekonomik të Kosovës sigurisht brenda mundësive, rrethanave dhe pengesave të vazhdueshme nga brenda dhe jashtë. Fakti se kamatat e bankave kanë rënë nga afro 15-20 për qind sa ishin para shpalljes së pavarësisë në më pak se 4 % në vitin 2021 e konfirmon zhvillimin ekonomik të Kosovës. Fakti që Kosova nga shkumbi e hiri i vitit 1999 ka arritur që deri në vitin 2021 të rrisë pagat e sektorit publik më shumë se çdo shtet në rajon dhe të ketë vlerësime pozitive nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për qëndrueshmëri makro-fiskale flet shumë për ecjen e jashtëzakonshme përpara, për ata që duan ta shohin;

7. Kosova vetëm pas shpalljes së pavarësisë, pra 2008-2011 kishte arritur ta stabilizonte furnizimin me rrymë elektrike kundrejt reduktimeve të shpeshta e ashpra që shkatërronin ekonominë. Anëtarësimi i Kosovës në Traktatin e Energjisë për Evropën Juglindore në vitin 2006 si dhe përkushtimi politik i Kosovës i mbështetur fuqishëm nga ShBA-ja e BE-ja e kanë stabilizuar furnizimin me rrymë. Ishte pikërisht stabilizimi i furnizimit me energji ai që mundësoi rritjen më të madhe ekonomike në rajon sipas Bankës Botërore dhe pse jo në Evropë. Një vend që s'ka energji, s'ka ekonomi, lufta kryesore sot në glob bëhet për furnizim me energji;

8. Kosova për 22 vjet çlirim dhe 13 vjet shtetësi ka arritur ta zhdukë hendekun e standardit jetësor fshat-qytet. Kjo është e arritura më e madhe dhe më e shpejtë në glob që Kosova ka arritur ta bëjë, thjeshtë e jashtëzakonshme. Asnjë shtet në Evropë dhe botë nuk ka mundur ta zhdukë më shpejtë këtë hendek se sa Kosova.

Ndërkohë alamet rajone e shtete në glob si tërë Amerika e Mesme dhe Jugore, Kina, India, Indonezia, Rusia, Evropa Juglindore, Turqia, Greqia, etj. edhe pse tashmë disa sosh janë ndër ekonomitë më premtuese në glob, s'kanë arritur dhe as do të arrijnë ta zhdukin hendekun e standardit jetësor fshat-qytet. Sot pra në Kosovë jetohej me të njëjtin standard si në fshat ashtu edhe në qytet, kurse para lufte dallimi ishte si nata me ditë. Shikoni sot fshatrat në Shqipëri, Bullgari, Rumani, Serbi, krahasoni me Kosovën dhe ejani flasin;

9. Kosova sipas Bankës Botërore dhe USAID, gjatë periudhës 2008-2021 ka qenë ndër ekonomitë më të përmirësuara në glob dhe në top vendet në glob që ka ndërmarrë reformat e nevojshme në favor të zhvillimit ekonomik. Fakti që Kosova ka depozitat bankare në rritje, sistem bankar stabil dhe likuid, ulje graduale të kamatave dhe rritje të eksporteve edhe në pandemi, tregon që baza e sektorit privat tashmë është shtruar dhe projeksionet janë premtuese, gjithnjë duke marrë parasysh vështirësitë me Serbinë, izolimin nga BE etj. Me trendet që është duke ecur, Kosova deri në vitin 2040 pritet që ta stabilizojë tërë infrastrukturën, ta fuqizojë sektorin privat së paku në nivel me rajonin dhe që së paku ta balancojë bilancin tregtar, nëse eksportet nuk tejkalojnë importet;

10. Kosova për 22 vjet çlirim dhe 13 vjet shtetësi ka arritur të nënshkruajë dhe ratifikojë mbi 500 marrëveshje ndërkombëtare. Vetë fakti që çdo vit BE-ja, ShBA-ja, Gjermania, Institucionet Financiare Ndërkombëtare (p. sh., Banka Botërore, EBRD, KfW etj.) dhe shumë shtete tjera nënshkruajnë dhe ratifikojnë me Kosovën marrëveshje të shumta financiare mes 150 deri në 300 milionë EUR e konfirmon që tërë bashkësia ndërkombëtare i besonte plotësisht shtetit të Kosovës, përndryshe s'do të nënshkruheshin të gjitha ato marrëveshje, që të gjitha të dokumentuara, ratifikuara e dekretuara që nga 1999 deri në 2021;

11. Kosova, pra institucionet e saj që oportunistët dhe qarqet dashakeqe i shanin, ndërsa sot të njëjta i lavdërojnë duke u thënë se kanë shënuar progres të paparë, duke plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga BE ka arritur që në vitin 2016 ratifikojë Marrëveshjen Stabilizim Asociim (MSA) si hapin e parë gjigant drejt integritimit evropian. MSA nuk do të përsëritet më, Kosova do të lëvizë në hapa të tjerë të integritimit evropian;

12. Kosova më shumë se çdo shtet në rajon dhe Evropë ka dhënë kontributin e saj në luftën ndaj radikalizmit fetar dhe terrorizmit

global. Për këtë ka marrë lëvdata edhe nga vendet më të fuqishme në glob. E paramendoni sa të reja i kishte Kosova institucionet për një sukses aq të madh ndërkombëtar; 13. Kosova më shpejtë se çdo shtet në Evropë ka përmirësuar infrastrukturën e saj duke i hapur kështu rrugë zhvillimit më të shpejtë në rajon të konfirmuar edhe nga Banka Botërore dhe USAID. E të gjithë e dinë se Kosova në vitin 1999 ishte bërë shkumb e hi, pastaj para vitit 1999 kishte vetëm 5 për qind rrugë të asfaltuara duke qenë tërësisht e përjashtuar nga rrugët rajonale. Këtë mosinvestim dhe mega-përjashtim socio-ekonomik Serbia pushtuese e bënte me qëllim, sepse Serbia e di mirë që kombet zhvillohen përmes rrugëve, prandaj Serbia me aleatë vazhdimisht insistonte që Kosova të ndërtonte autostrada. Të gjitha këto mega-investime Kosova i ka bërë duke e mbajtur borxhin publik më të ulët në Evropë për kokë banori në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Për më tepër vetë Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe BE e kanë konfirmuar që Kosova ka rrugët më të sigurta në rajon;

14. Kosova ka pasur dhe ende ka bumin më të madh në rajon të ndërtimeve në qytete dhe fshatra. E bumi i ndërtimeve e konfirmon që në Kosovë ka pasur dhe ka kapital të madh financiar. Bumi i ndërtimeve vazhdon edhe sot me ritme të papara, mjafton të krahasojmë Prishtinën me kryeqytetet e rajonit, një Prishtinë së cilës sot mund t'i sillesh përreth pothuaj së tërës me autostrada klasë, diçka që sot e ka veç Athina, Beogradi, Zagrebi e Shkupi e ende s'e kanë Tirana, Podgorica, Sarajeva, Sofja, Bukureshti etj;

15. Kosova ka arritur të ketë numër më të madh të veturave për kokë banori në rajon, përfshirë veturat e reja, pa përfshirë këtu numrin e makinerive tjera të rënda. Ndërkohë që para lufte s'i shihje dy tri vetura në një fshat e mos të flasim për makineri të rënda;

16. Kosova, edhe pse e penguar fort nga Serbia, ka arritur që edhe pas vitit 2008 deri në 2021 me mbështetje të fuqishme ndërkombëtare të anëtarësohet në të gjitha organizatat dhe mekanizmat pasuese rajonale si palë e barabartë me Serbinë dhe të gjitha shtetet e rajonit. Si para pavarësisë ashtu edhe pas saj Kosova vazhdimisht i ka hyrë integritimit rajonal, nuk ka pritur ç'është Serbia, sepse po ta kishim pritur ç'është Serbia, as pavarësinë s'e kishim shpallur. Nëse presim që me presion tonin ta gjuhëzojmë Serbinë, atëherë e kemi ngatërruar planetin. Hyrja e Kosovës në të gjitha nismat (njëjtë sikur Serbia) në Procesin e



Stabilizim Asociimit, Paktin e Stabilitetit, CEFTA, Procesin e Berlinit, ratifikimi i MSA-së, e shumë nisma e marrëveshje tjera e konfirmojnë këtë, të gjitha të faktuara;

17. Kosova për dallim prej vendeve të rajonit ka bashkëpunuar pa asnjë rezervë me Tribunalin e Hagës dhe së fundmi me Gjykatën Speciale, ndërsa shtetet e rajonit vazhdimisht e kanë bojkotuar këtë proces. Përderisa Kosova ka marrë lëvdata të mëdha për këtë bashkëpunim, asnjëherë s'është shpërblyer sa dhe si duhet për këtë, shih këtu izolimin edhe sot nga BE me mosliberalizim të vizave për Kosovën;

18. Kosova, sipas "World Justice Project 2020" ka ecur në sundim të ligjit më shumë se çdo shtet në rajon si dhe sipas Crime Index by City 2021 në 109 qytete të Evropës, kryeqytetet e BE-së e rajonit prijnë sa i përket niveleve të larta të krimin, ndërkohë që Prishtina nuk figuron fare. Ndërkohë Serbia përpos që gurgullon nga korrupsioni, krimi dhe e kaluara gjenocidale ndaj rajonit, edhe sot vazhdon të mos i njeh kufijtë e

rajonit, të flirtojë hapur me Rusinë e Kinë, ta poshtërojë BE-në dhe megjithatë të ledhatohet nga ajo;

19. Kosova më shumë sesa çdo shtet në rajon dhe Evropë ka qenë tërësisht e rreshtuar kah perëndimi dhe në këtë drejtim ka dëshmuar bashkëpunim të plotë. Kosova për 22 vjet çlirim e 13 vjet shtetësi asnjëherë s'i ka kthyer shpinën ShBA-së e BE-së, asnjëherë s'i ka kundërshtuar marrëveshjet që vijnë nga ShBA-ja. Nënshkrimi i Kosovës së Marrëveshjes së shtatorit 2020 në Shtëpi të Bardhë ka qenë ndoshta i pari dhe i fundit nga politika shqiptare dhe kjo ka qenë një e arritur kolosale për Kosovën për ta rikonfirmuar rreshtimin krah perëndimit ku për shqiptarët "lindi dielli". Fakti që Kosova bashkëpunonte ngushtë dhe nënshkruante marrëveshje në Shtëpi të Bardhë, me BE-në dhe përkundër pengesave serbe e ruse arrinte të futej në të gjitha nismat, organizata, mekanizmat dhe projeksione rajonale si e barabartë mes të barabartëve flet më së miri për orientimin tërësisht properëndimor të saj;

20. Kosova është anëtarësuar në

Bankë Botërore, Fond Monetar Ndërkombëtar, FIFA, UEFA dhe shumë e shumë mekanizma tjerë ndërkombëtarë. Po të mos ekzistonte besim në politikën e Kosovës, kjo sigurisht që nuk do të ndodhte. Përkundrazi, Kosova që nga viti 1999-2021 ka bashkëpunuar ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe çdo projeksion ekonomik e ka bërë në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në, ShBA-në dhe BE-në, faktet flasin vetë;

21. Kosova ka arritur të sigurojë ngrohje dhe furnizim me ujë 24 orë për Prishtinën, të zgjerojë rrjetet e ngrohjes nëpër qytete, si dhe ka përmirësuar dukshëm furnizimin me ujë nëpër tërë Kosovën, ashtu sikundër që ka filluar me ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza për qytete të mëdha, diçka për të cilën njerëzit as që kishin ëndërruar. Përpos kësaj Kosova qysh në vitin 2015 (me vetëm 7 vjet shtetësi) në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare kishte arritur të bënte projeksione të jashtëzakonshme për ujë (për pije, ujtiqe, energji, kanalizime) deri në vitin 2034; të gjitha projektet sot

janë duke ecur sipas atyre projeksioneve. Kush ka pritur që të rregullohen të gjitha problemet për 22 vjet çlirim dhe 13 vjet shtetësi në një vend me thes të tërë të shqyer, e ka ngatërruar planetin;

22. Kosova për 22 vjet çlirim dhe vetëm 13 vjet shtetësi, edhe pse e penguar fuqishëm nga Serbia dhe Rusia, ia ka arritur të bëhet pjesë e të gjitha projeksioneve të rrjeteve infrastrukturore rajonale: rrugore, ajrore, hekurudhore, digjitale, telefonike, gazit, rrymës elektrike, etj. Kjo sepse Kosova dhe Shqipëria i dinë më së miri pasojat e izolimit dhe mosintegritimit në rrjete rajonale dhe evropiane. Më së shumti Kosova ka ecur në drejtim të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe është në rrugë të mirë drejt Malit të Zi dhe Serbisë. Miliarda euro janë shpenzuar dhe pritet të shpenzohen në kuadër të Procesit të Berlinit, Procesit të Stabilizim Asociimit dhe nga ShBA-ja, të gjitha projektet e realizuara janë të prekshme dhe të matshme për ata që duan t'i shohin;

Sigurisht që Kosova nuk ka mundur që për 22 vjet çlirim e

vetëm 13 vjet shtetësi të bëhet as Zvicër e as Gjermani, sepse rrethanat e tmerrshme historike nëpër të cilat ka kaluar e pamundësonin një gjë të tillë, pavarësisht dëshirave, ëndrrave dhe pritjeve. Por ama, nga shkruimi e hiri dhe nga shkretimi i qëllimshëm dhe planifikuar i pushtuesit serb që nga 1945 deri në 1999, duke mos harruar këtu edhe gjendjen super të mjerë të popullit shqiptar të trashëguar që nga Perandoria Osmane, rënia e saj e deri në 1945, Kosova sot përbën rast unik në botë, ku për vetëm 22 vjet çlirim dhe vetëm 13 vjet shtetësi edhe pse ende e izoluar nga Evropa dhe me 100 pengesa nga Serbia e Rusia, ka arritur që megjithatë të bëhet shtet me të gjithë aparatit e nevojshëm shtetëror, me sektor privat në zhvillim e sipër, kuptohet dhe me vështirësi në qeverisje, përfshirë keqpërdorimet korruptive dhe shpërdorimin e resurseve njerëzore, sfida këto të cilat sikurse çdo në shtet në botë do të na shoqërojnë edhe në të ardhmen dhe nuk do të përfundojnë kurrë, pavarësisht trumbetimeve shterpe.

## Refugjatët afganë dhe rikthimi i kujtesës



Shkruan: Bajram MJEKU

Mbërritja e refugjatëve afganë mbrëmë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës më solli në kujtesë fluturimin e familjes sime dhe të mijëra kosovarëve nga Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit në gjysmën e dytë të prillit të vitit 1999.

Rrallë ndodh në historinë e njerëzimit të fluturosh me avion drejt një shteti tjetër pa asnjë dokument identifikimi! Ka ndodhur kështu me mijëra kosovarë të cilët janë evakuuar për t'u strehuar nga Evropa deri përtej oqeanit.

Ditët e fundit në rrjete sociale pati vlerësime të ndryshme për afganët. Për fat të keq, pati edhe qëndrime raciste, por nuk duhet harruar një fakt: vetëm njëzet e dy vjet më parë këtë fat tragjik e kishim edhe ne.

Nuk e di si do t'i presim ne afganët dhe sa do të jemi të kujdesshëm në raport me ta, por e di që në Mbretërinë norvegjeze jemi pritur jashtëzakonisht ngrohtë, me theks të veçantë unë dhe familja ime. Sapo kemi zbritur në Aeroportin e Kristiansandit jam intervistuar nga mediat e vendit dhe një ditë më vonë jam intervistuar nga organet e policisë. Më kujtohet kur një nga ata gjatë intervistimit më tha: "Jeni shqiptari më i afirmuar në Norvegji brenda njëzet e katër orëve të fundit!". E kishte fjalën për intervistën time dhënë mediave vendore dhe për kureshtjen që kishte zgjuar intervista te qytetarët e mrekullueshëm norvegjezë, në kohën kur në Norvegji kishin nisur të strehoheshin mbi shtatë mijë kosovarë. Sapo kam dhënë shenjat e gishtërinjve, mua dhe familjen na pajisën me karta identiteti, përmes të cilave na

jepej mundësia t'i vizitonim të gjitha shtetet skandinave. Të njëjtën ditë jam ftuar në darkë nga gazetarët e qytetit të Kristiansandit dhe, pas darkës që shtruan për nder timin, më dhuruan një kompjuter. Pa kaluar java autoritetet norvegjeze mua dhe familjen na transferuan në kryeqytetin norvegjez në Oslo ku jetuam plot dy vjet.

Statusi ynë në Mbretërinë norvegjeze ishte shumë i avancuar dhe në afat kohor prej një viti ishim nën mbrojtje të shtetit. Brenda një kohe të shkurtër na doli e drejta për punë, më saktë i gëzonim të gjitha të drejtat njësoj si shtetasit norvegjezë. Unë me familjen jemi kthyer vullnetarisht mbas dy vjetësh qëndrimi, por qindra familje kosovare kanë kërkuar të qëndrojnë përjetësisht atje dhe këtë të drejtë e kanë fituar...

Lidhur me afatin e qëndrimit të afganëve në Kosovë, kanë filluar të qarkullojnë opinione të ndryshme. Mendja ma thotë se nëse afganët vendosin të jetojnë në Kosovë, këtë të drejtë do ta gëzojnë. Kështu ndodhi me mijëra kosovarë gjatë luftës së fundit në Kosovë të cilët kanë mbetur në shtetet ku janë sistemuar nga Evropa deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Besoj fort që qëndrimi i afganëve në Kosovë, por edhe në shtetet e tjera ku do të sistemohen, do të ndodhë në tri faza kohore. Faza e parë e qëndrimit prej katërmëdhjetë muajsh, do të pasojë me fazën e dytë të mundësisë së vazhdimit edhe për katërmëdhjetë muaj të tjerë, ndërsa faza e tretë do të jetë pajisja me dokumente me të gjitha të drejtat për të qenë shtetas të Kosovës! E gjithë kjo tash e tutje do të varet nga vullneti i afganëve më shumë se nga vullneti ynë. Po, sepse e gjithë sakrifica jonë ndër breza ishte që Kosova të bëhej shtet, prandaj edhe Kosova është e obliguar t'i përbushë të gjitha të drejtat dhe obligimet ndërkombëtare që dalin për refugjatët njësoj si të gjitha shtetet e tjera, pavarësisht ngjyrës, racës dhe religionit që përfaqësojnë ata.



Foto: Djali im Orgesi para Pallatit Mbretëror në Oslo





**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Challandes: Duhet ta ndryshojmë mentalitetin për të ecur përpara

Trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se është e domosdoshme që futbollistët “dardanë” të ndryshojnë mentalitetin nëse dëshirojnë të ecin përpara. Ai shembull ka marrë edhe suksesin e Italisë në Kampionatin Evropian, pasi e ka ndryshuar mentalitetin pas dështimit në Kampionatin Botëror

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 30 GUSHT** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i zhvillojë tri ndeshje kualifikuese në muajin shtator. “Dardanët” më 2 shtator përballen me Gjeorgjinë, pastaj më 5 shtator e presin Greqinë dhe tri ditë më vonë Spanjën. Përzgjedhësi Bernard Challandes të hënën është paraqitur në konferencë për media. Trajneri zviceran ka thënë se futbollistët “dardanë” duhet ta ndërrojnë mentalitetin. “Në ditët e ardhshme do të kemi tri ndeshje të vështira dhe interesante. Nuk mund të them se për ne është fillimi i një fushate të re, pasi kemi luajtur dy ndeshje. Por, mund të them se është fillim i ri, pasi kemi pasur një periudhë të suksesshme dhe të pasuksesshme. Për mua është koha që të rindërtojmë një ekip të fortë. Nuk kemi qenë në Evropian, por duhet të marrim

mësime nga ky turne. Ka ardhur koha të krijojmë një skuadër që ka vlera sikurse më herët. Është koha që të kemi një mentalitet të fortë dhe të duhur për Kosovë”, ka thënë Challandes. “Fatkeqësisht, nuk është koha për një situatë të tillë, pasi kemi disa telashe me futbollistë. Edhe pse nuk është koha e duhur për këtë, është koha të japim një reagim. Kemi përcjellë Evropianin dhe kemi pasur mundësi të shohim gjëra të rëndësishme. Nuk kanë të bëjnë me aspektin fizik e as taktik, por me mentalitetin. Është koha që Kosova menjëherë ta ndryshojë mentalitetin dhe nëse këtë nuk e bën prej ndeshjes së ardhshme, do të kemi sërish probleme. Kjo nënkupton se unë menjëherë do të flas sonte me ekipin se duhet ta ndryshojmë mentalitetin tonë, pasi ky është fokusi im gjatë këtij grumbullimi”, ka shtuar ai. Trajneri Challandes ka thënë se nuk e ka mendjen të kualifikimi në Kampionatin Botëror, por të progresi i ekipit. Ai ripërsëriti se



dëshiron që të ndryshohet mentaliteti te Kosova, pasi edhe Italia triumfoi në Kampionatin Evropian vetëm pasi ndryshoi mentalitetin. “Nuk e kam mendjen të kualifikimi në Kampionatin Botëror, por të progresi i ekipit. Tani në mendjen time është vetëm ndeshja me Gjeorgjinë dhe duhet të reagojmë për të dëshmuar se kemi bërë progres. Sa i përket mentalitetit, ky është ndryshimi i parë që na duhet. Ka tri vjet që jam në krye të Kosovës dhe është e qartë që jam i pakënaqur në këtë aspekt, për këtë arsye jam fokusuar të ndryshimi i

mentalitetit. Falë mentalitetit, edhe Italia arriti të triumfojë në Evropian pas dështimit në Botërorin e Ruisë. Mançini ndryshimi e parë në ekip që e ka bërë ishte ndryshimi i mentalitetit”, ka deklaruar Challandes. Trajneri Bernard Challandes foli edhe për situatën e krijuar me dy futbollistët Leart Paqarada dhe Bernard Berisha, të cilët kanë bërë me dije se nuk do të jenë pjesë e Kosovës derisa trajner të jetë Challandes. “Leart Paqarada ka vendosur mos të vijë në ekip, sjellja e tij e ka treguar tashmë këtë. Mua

më pëlqen Paqarada, por ai ka vendosur. Nëse ai konsideron se është momenti për të diskutuar, atëherë do të tentojmë të diskutojmë dhe të flasim për situatën. Është e njëjta situatë edhe me Berishën. Ai nuk ndihet mirë, por unë nuk ndryshoj. Ai dëshiron të ketë garanci për pozicionin e tij në ekip, por nuk mund t'i garantojmë askujt se mund të luajë rregullisht”, ka pohuar Challandes. Përfaqësuesja e Kosovës të premtën në mbërmje zhvilloi edhe stërvitjen e parë për ndeshjet e muajit shtator.

## FBK-ja organizon Superkupën në Prishtinë



**PRISHTINË, 30 GUSHT** - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) do ta organizojë Superkupën e Kosovës në basketboll në konkurrencën e meshkujve nga 1 deri më 5 shtator. Superkupa do të organizohet në Prishtinë, ku priten ndeshje shumë interesante mes tetë skuadrave të elitës. Të gjitha skuadrat kanë bërë transferime, duke bërë që ky edicion të pritet me interesim të madh. Të mërkurën, më 1 shtator, do të përballen Prizreni 16 dhe Drita, si dhe klasikja e basketbollit të

Kosovës në mes të Pejës dhe Sigal Prishtinës. Ndeshje interesante priten edhe të enjten, ku përballen Rahoveci dhe Trepça, si dhe Golden Eagle Ylli dhe Bashkimi. Të premtën do të zhvillohen takimet gjysmëfinale, kurse finalja e madhe të dielën. Për shkak të masave të reja kundër Covidit, ndeshjet do të zhvillohen pa shikues. Edicionin e kaluar Superkupën e kishte fituar Sigal Prishtina me lojtarë vendorë, duke mundur në finale Bashkimin.

ORARI	
<b>1 Shtator/Grupi A-D</b>	16:00 Prizreni-16 - Drita 19:00 Peja - Sigal Prishtina
<b>2 Shtator/Grupi B-C</b>	16:00 Rahoveci - Trepça 19:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi
<b>3 SHTATOR</b>	16:00 Gjysmëfinalja e I (Fituesit e Grupit A-D) 19:00 Gjysmëfinalja e II (Fituesit e Grupit B-C)
<b>4 Shtator/Pushim</b>	
<b>5 Shtator/Finalja 17:00</b>	

## BKT-ja, sponsore e Superligës

**PRISHTINË, 30 GUSHT** - Federata e Futbollit e Kosovës ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me Bankën Kombëtare Tregtare Kosovë (BKT), që do të jetë sponsore gjenerale e Superligës së

Kosovës në futboll e cila do të quhet BKT Superliga. Për më tepër, në mbështetje të digitalizimit të futbollit në Kosovë, BKT do të sponsorizojë edhe zhvillimin e platformës digjitale – sistemin

elektronik të shitjes së biletave për BKT Superligën. Kontratën e partneritetit e kanë nënshkruar presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe drejtori ekzekutiv i BKT-së, Suat Bakal.





## PSG-ja refuzon ofertën e Realit, Mbappe qëndron edhe për një sezon

PARIS, 30 GUSHT - Kylian Mbappe do të vijojë të luajë me fanellën e Paris Saint Germainin edhe për një tjetër sezon. Klubi francez vijon të bëjë rezistencë ndaj Realit të Madridit dhe nuk ka ndërmend ta shesë. Drejtuesit e PSG-së janë treguar të qartë, që do të lejojnë Mbappen të largohet nga "parku i

princave" vetëm me kushtet e tyre, përkthyer ndryshe në rast të një oferte prej 200 milionë eurosh. Real i Madridit ka shkuar deri në 170 milionë euro dhe nuk ka ndërmend ta rritë ofertën, duke qenë se bëhet fjalë për një futbollist që vetëm 10 muaj më vonë do të jetë i lirë të vendosë vetë të ardhmen e tij.

Megjithatë, kjo ofertë është refuzuar prerë nga drejtuesit e PSG-së, të cilët duken më të bindur se kurrë që Mbappe do të vijojë të qëndrojë në kryeqytetin francez edhe sezonin e ardhshëm, ndërsa në Madrid ka rënë ndjeshëm optimizmi që mbizotëronte në mediat pranë klubit të Realit.



## Gjimshiti: Shqipëria ka shanse, por nuk duhet të kemi frikë

TIRANË, 30 GUSHT - Berat Gjimshiti, mbrojtësi i kombëtares shqiptare, ka dalë para mediave dhe ka folur për duelin e radhës të kuqezinjve kundër Polonisë. Një finale për skuadrën e ekipit të drejtuar nga Edy Reja, për të shpresuar në kapjen e vendit të dytë. "Ka qenë një sezon shumë i gjatë, sidomos për mua. Kemi zhvilluar shumë ndeshje me klubin dhe kombëtaren. Kemi pasur nevojë për këtë pushim, për t'u rikuperuar. Me kombëtaren kemi bërë hapa para, në këto tri ndeshje do të shohim si do të dalim dhe do ta japim maksimumin për të marrë sa më shumë pikë", ka thënë Gjimshiti. "A kemi shanse kundër Polonisë? Sigurisht që po. Kemi bërë hapa pozitivë. Duhet të kemi shumë respekt për Poloninë, pasi ka lojtarë që janë ndër më të mirët në botë. Duhet të shohim skuadrën tonë, të marrim rezultat pozitiv. Lewandowski? Nuk ka shumë për të studiuar. Të gjithë i shohim më të mirët, edhe te Bayerni Lewandowski po shënon gola. Do të jetë një duel



shumë i bukur. Do të jap maksimumin tim. Të shohim si do të dalë", ka deklaruar Gjimshiti. Mbrojtësi i Atalantës në Itali ka thënë se futbollistët kuqezinj nuk duhet të kenë frikë nga kundërshtari. "Duhet të mos kemi frikë. Nëse frikësohesh, bën gabim në këtë punë. Të gjithë

lojtarët kanë fituar përvojë dhe kur luan ndaj lojtarëve të nivelit kaq të lartë, rritet edhe vetëbesimi për secilin futbollist. I gjithë ekipi ka përvojë. Çdo fitore të jep motivimin më të madh. Sa iu përket tifozëve, jam shumë i lumtur që do të kthehen, sepse na kanë munguar", ka shtuar qendërmbrojtësi shqiptar.

## Bajrami vesh fanellën kuqezi

TIRANË, 30 GUSHT - Nedim Bajrami është tashmë zyrtarisht pjesë e kombëtares shqiptare. Federata Shqiptare e Futbollit prej disa muajsh kishte nisur procedurat për të bërë të mundur aktivizimin e Bajramit me Shqipërinë por, pas refuzimit të parë nga organet ndërkombëtare, Drejtoria Juridike e FShF iu drejtua Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Sportiv në Lozanë. Pas përgatitjes së dosjes voluminoze, me të gjithë dokumentacionin e duhur, konsultimit me ekspertët më të mirë të drejtësisë dhe shumë orëve punë, Federata Shqiptare e Futbollit arriti të triumfojë në CAS duke arritur të sigurojë shërbimet një lojtar që do ta ndihmojë shumë skuadrën tonë kombëtare siç është shprehur



edhe trajneri Edoardo Reja. Gjyqi i dytë ndërkombëtar që fiton Federata Shqiptare e Futbollit, kjo pa diskutim një arritje shumë e rëndësishme për institucionin e futbollit në vend, që tregon se

duke përgatitur procese të rregullta dhe punuar në mënyrë serioze, drejtësia triumfon, ashtu siç ishte rasti i gjyqit ndërkombëtar për ndeshjen Serbi - Shqipëri.

### SHKURT

#### Brightoni e huazon Zeqirin në Gjermani

Klubi i Premierligës angleze, Brighton, e ka huazuar sulmuesin nga Kosova, Andi Zeqiri, te skuadra e Bundesligës së Gjermanisë, Augsburg. Lajmin e ka konfirmuar trajneri i Brightonit, Graham Potter. "Andi është një nga lojtarët tanë të rinj të uritur për të luajtur. Është momenti kyç që ai të luajë diku më shumë dhe të zhvillohet edhe më shumë si futbollist. Kalimi te Augsburg është lëvizje e shkëlqyeshme për Andin dhe ne do të mbajmë sytë anej duke e përcjellë përparimin e tij si futbollist", ka thënë Potter.

#### Ronaldo përfundon testet mjekësore dhe nënshkruan kontratën me Unitedin

Cristiano Ronaldo ka përfunduar testet mjekësore dhe ka nënshkruar kontratën me Manchester Unitedin. Ronaldo ka nënshkruar kontratë dyvjeçare dhe do të bëhet lojtari më i paguar ndonjëherë në Premier Ligë. Ole Gunnar Solskjaer u shpreh i lumtur me nënshkrimin e Ronaldos, dje pas ndeshjes, shkruan "Skysports". "Sigurisht që ne jemi të ngazëllyer nga e gjithë historia që Cristiano ka pasur në Manchester United", ka thënë ai për "Sky Sports". "Ai është një fitues. Lojtarët janë të ngazëllyer, dhe unë jam i ngazëllyer. Ai shton diçka krejtësisht tjetër në ekip. Ai shton më shumë besim në atë që ne po bëjmë dhe atë që ne po ndërtojmë", u shpreh Solskjaer. Procesi i vizave tashmë ka filluar në mënyrë që Cristiano Ronaldo të jetë në dispozicion për ndeshjen e ardhshme të Unitedit kundër Newcastle.

#### Verstappen: Nuk më pëlqen kjo fitore, gara është dashur të zhvillohet më herët

Max Verstappen "fitoi" me vetëm tri xhiro garën e Çmimit të Madh të Belgjikës në Formula 1, një garë e çuditshme, ku shiu ishte protagonist absolut, që e bëri të pamundur zhvillimin normal të garës. Piloti holandez i Red Bullit ngushtoi disi diferencën me Lewis Hamiltonin. "Në këtë garë e rëndësishme ishte vetëm sfida për pole position. Mëkat që nuk garuam, por kushtet atmosferike ishin jo të mira", ka thënë Verstappen. "Kjo është një fitore që nuk më pëlqen. Ata që meritojnë duartrokitje janë fansat që qëndruan deri në fund", u shpreh Verstappen. Piloti holandez ka një merak, që gara duhej të niste më herët. "Mendoj se nëse gara do të niste në orën 15:25, siç ishte planifikuar në fillim, do të kishim kushte më të mira. Tani gjithçka mbaroi dhe na duhet të shohim garën e radhës, pasi botërori është ende i gjatë", ka shtuar Verstappen.

#### Lazio shfaq interesim për Riberyn

Franck Ribery do të mbetet në Serinë A, edhe pse i ka mbushur 38 vjeç. Anëtori u aktivizua rregullisht te Fiorentina dy sezonet e fundit në 50 ndeshje dhe vetëm tri prej tyre i nisi nga stoli. Klubi "vjollcë" nuk ia ofroi rinovimin, ndërkohë që së fundmi në lojë për të është futur Lazio. Për të arritur te Kostić është e vështirë, ndaj drejtuesit e klubi italian janë pranë marrëveshjes me Riberyn. Pritet që shumë shpejt të vijë edhe njoftimi i klubit italian. Ribery do të ishte një alternativë për trajnerin Sarri, si dhe një lojtar i rëndësishëm për Lazion, sidomos në dhomat e zhveshjes.

## Dias vazhdon kontratën me Cityn

Ruben Dias ka nënshkruar kontratë të re gjashtëvjeçare me Manchester Cityn, duke e mbajtur atë në klub deri në vitin 2027. 24-vjeçari mbërriti në "Etihad Stadium" nga Benfica gjatë afatit kalimtar të verës së kaluar

dhe bëri një ndikim të menjëhershëm me mendjemprehtësinë e tij mbrojtëse, cilësinë teknike dhe mentalitetin fitues, të gjithë dëshmuar përbërësit kryesorë në një sezon debutues madhështor për Cityn, thuhet në

faqen zyrtare të Manchester Cityt. Ai i bëri 50 paraqitje në të gjitha garat në sezonin e parë me Citizens duke ndihmuar skuadrën që të fitojë titullin e Premier Ligës dhe Kupën Carabao, si dhe arriti në finalen e parë të

Ligës së Kampionëve. Për më tepër, Dias u votua si lojtari i sezonit në Premier Ligë ashtu edhe lojtari i sezonit në Manchester City dhe javën e kaluar ai u shpall mbrojtësi i sezonit në Ligën e Kampionëve.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ V-Kastrati” Sh.p.k. Zahaq, Pejë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Zahaq, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.09.2021 në ora 09:00 ne zyret e objektit të Bases se Betonit te kompanis V-Kastrati shpk ne Zahaq komuna e Pejes, do të organizohet debat publik nga Kompania “ V-Kastrati” Sh.p.k. Zahaq, Pejë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për bazën për prodhimin e betonit në Zahaq, Pejë

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

#### Platforma ZOOM

Linku: <https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvOmphd1o3bW8vckxadVorOT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ V-Kastrati” Sh.p.k. Zahaq, Pejë, për bazën për prodhimin e betonit në Zahaq, Pejë.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ AK ReMetInd ” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën e grumbullimit dhe trajtimit fizik të katalizatorëve dhe mbetjeve elektronike në Koretishtë, Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.09.2021 në ora 13:00 në lokalet e kompanis “ AK ReMetInd ” Sh.p.k, në Koretishtë, Novobërdëdo të organizohet debat publik nga Kompania “ AK ReMetInd ” Sh.p.k. Prishtinë., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën e grumbullimit dhe trajtimit fizik të katalizatorëve dhe mbetjeve elektronike në Koretishtë, Novobërdë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvOmphd1o3bW8vckxadVorOT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ AK ReMetInd ” Sh.p.k. Prishtinë.për qendrën e grumbullimit dhe trajtimit fizik të katalizatorëve dhe mbetjeve elektronike në Koretishtë, Novobërdë.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Dafi Beton’ Sh.p.k. Lipjan., në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin për prodhimin e betonit në Banullë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.09.2021 në ora 09:00 në Restorant Eleganca, i cili gjendet pran rrugës regjionale Hasan Prishtina, ne fshatin Llugaxhi te komunës Lipjanit do të organizohet debat publik nga Kompania “ Dafi Beton’ Sh.p.k. Lipjan., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin për prodhimin e betonit në Banullë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: 1YsD3f

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Dafi Beton’ Sh.p.k. Lipjan për Impiantin për prodhimin e betonit në Banullë.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mehreme Mala shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “ Fehmi Lladrovi” Drensa.

► Ejup Gashi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330306440.

► Rabije Kurteshi Ferati shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni" nga klasa 9 -6

► Valentina Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni"

► Valentina Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 9-te te gjimnazit " Frang Bardhi"

► Valentina Kurti shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi"

► Daut Gashi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani" (Ish Boris Kidric)

► Diellza Dibrani shpalle te pavlefshme dëftesën e SHMU "Azem Bejta"

► Gentrit Krasniqi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Abdullah Shabani"

► Medi Construction "Sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 71344886

► D.p.t "Suela" shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 70725703.

► Nexhdet Morina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

► Bleta Komoni shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

